



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Manual
Për ndjekjen e zbatimit
të rekomandimeve të auditimeve
të Kontrollit të Lartë të Shtetit
dhe
Regjistri elektronik institucional





KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT
KRYETARI

Nr. 341/Prot.
17

Tiranë, më 23/6/2020

VENDIM

Nr. 67, Datë 23/6/2020

PËR

MIRATIMIN E MANUALIT TË NDJEKJES SË ZBATIMIT TË
REKOMANDIMEVE SI DHE TË REGJISTRIT
INSTITUCIONAL TE ZBATIMIT TE REKOMANDIMEVE

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit; në zbatim të kërkesave të Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t (IFPP); me qëllim përmbushjen e objektivave të vendosura në Strategjinë e Zhvillimit Institucional 2018-2022; KLSH në vijimësi ka patur në fokus të zhvillimeve metodologjike institucionale, konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si dhe të mekanizmave të raportimit konsideruar si rrugën e vetme të përmbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional si dhe pritshmërive të Kuvendit, publikut dhe gjithë palëve të interesit.

Skemat dhe qasjet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve që trajtohen në këtë manual përfaqësojnë një progres dhe hap përpara për gjenerimin e indikatorëve të konsoliduar institucional, të nivelit të pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve në afatet më të afërta të mundshme që lejojnë përcaktimet e ligjit Organik të KLSH-së, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj ekzekutivit me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.

Rishikimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit për auditimet financiare, të përputhshmërisë, të performancës dhe teknologjisë së informacionit, përmbushja e objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2022 në të cilën përcaktohet se "Efekti real i aktivitetit auditues së KLSH-së matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet publike" dhe implementimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian në kuadrin e proceseve të integritetit evropian të vendit sipas të cilit "Shqipëria duhet të marrë masa për implementimin në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm publik" e bëri të domosdoshëm rishikimin e kuadrit ekzistues (Udhëzimi nr 1 date 04.11.2016) duke finalizuar hartimin e një metodologjie bashkëkohore që reflekton praktikën më të mira të fushës dhe materializon përputhshmërinë e objektivave strategjike për modernizimin e institucionit të auditimit publik në Shqipëri.

Manuali i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si dhe të Regjistrit institucional të zbatimit të rekomandimeve, produkt i kontributit të Grupit të Punës (Luljeta Nano, Gjovalin Preçi, Alma Shehu, Aldo Kita dhe Elisona Papadhima) ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 45, datë 31.03.2020 "Për ngritjen e Grupit të punës për hartimin e Manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si dhe të Regjistrit institucional të zbatimit të rekomandimeve";
Sa më sipër;

VENDOSA:

1. Miratimin e Manualit të Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve si dhe të Regjistrit Institucional të Zbatimit të Rekomandimeve, bashkëlidhur këtij Vendimi;
2. Procedurat për verifikimin dhe raportimin e zbatimit të rekomandimeve që janë në proces, do të vijojnë të kryhen bazuar në kuadrin rregullator ekzistues dhe periudha deri në fund të vitit 2020, të shërbejë si periudhë e njohjes trajnimit dhe pilotimit për implementimin e kërkesave të këtij manuali.
3. Ngarkohet Departamenti i Metodologjisë dhe Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit, për përfshirjen në planin e trajnimeve dhe organizimin e veprimtarisë trajnuese për njohjen e gjithë stafit auditues me këtë Manual.
4. Ngarkohet Drejtoria e Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënjeve me Jashtë për publikimin e Manualit në website-n e KLSH-së.
5. Ky vendim hyn në fuqi më datë 23.06.2020






Kontrolli i Lartë i Shtetit

Manual

***Për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të
auditimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit***

dhe

Regjistri elektronik institucional



PËRMBAJTJA

Hyrje	4
Kapitulli I. Të përgjithshme	6
1.1. Qëllimi i hartimit të manualit	6
1.2. Baza ligjore	6
1.3. Përkufizime	11
1.4. Monitorimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve	12
1.5. Afati përfundimtar i deklaramentit të statusit të rekomandimit	14
1.6. Statusi i zbatimit të rekomandimeve	14
Kapitulli II. Metodologjia dhe sistemi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve	17
2.1. Metodologjia për hartimin e rekomandimeve	17
2.2. Sistemi i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve	18
Kapitulli III. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve	21
3.1. Planifikimi vjetor	21
3.2. Procedura që ndiqet gjatë auditimit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve	21
3.3. Kryerja e auditimit në subjekt	22
3.4. Raportimi	24
3.5. Raporti i konsoliduar i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në nivel institucioni	25
Kapitulli IV. Regjistri elektronik institucional i zbatimit të rekomandimeve	27
4.1. Të Përgjithshme	27
4.2. Regjistri elektronik i rekomandimeve	28
4.2.1. Rrjedha logjike e informacionit, ndërveprimi i përdoruesve për përditësimin e regjistrit gjatë ciklit jetësor të rekomandimeve dhe raportimi	30
4.2.1.1 Përshkrimi i ciklit jetësor të rekomandimit.	31
4.2.2 Përgjegjësitë dhe të drejtat në lidhje me përditësimin e regjistrit të rekomandimeve dhe statusit të rekomandimeve sipas fazave të ciklit jetësor të rekomandimit.	33
4.2.3 Të drejtat dhe përgjegjësitë e përdoruesve	35
4.2.3.1 Përgjegjësitë e përdoruesve të sistemit simmpa	35
4.2.3.2 Të drejtat e përdoruesve në regjistër	36

4.2.3.3 Niveli i aksesit që kanë përdoruesit në sistem.	38
4.2.3.4 Të drejtat dhe përgjegjësitë e administratorit	39
4.3. Arkivimi i të dhënave	41
Kapitulli V. Raportimi i rezultateve të auditimit mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve	42
5.1. Raportimi periodik për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve	42
5.2. Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara.	42
5.3. Përditësimi me informacionin e nevojshëm të platformës elektronike të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.	43
ANEKSE	45
Aneksi 1. Listë për monitorimin dhe zbatimin e rekomandimeve	45
Aneksi 2. Raporti i konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.xxxx-30.06.xxxx, përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë në muajin Mars të vitit aktual dhe Shkresa përcjellëse	47
Aneksi 3. Raporti i konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.xxxx-31.12.xxxx, përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë në muajin Shtator të vitit aktual dhe Shkresa përcjellëse	50
Aneksi 4. Regjistri Elektronik	53
Tabela e Shkurtimeve	56

Hyrje

Në përmbushje të detyrimeve kushtetuese ligjore si dhe në funksion të informimit të Kuvendit dhe të opinionit publik, Kontrolli i Lartë i Shtetit, përmes kryerjes së veprimtarisë audituese, synon që krahas dhënies së sigurisë për menaxhimin e fondeve publike dhe adresimit të rekomandimeve me efekt përmirësues dhe korrigjues, të kryejë ndjekjen e zbatimit tyre në një linjë me parimet, metodologjitë dhe procedurat e sanksionuara në Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t (IFPP) dhe praktikat më të mira të Institucioneve Supreme të Auditimit të komunitetit INTOSAI.

Boshti i filozofisë së politikave menaxheriale të KLSH-së, për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, i referohet faktit që performanca institucionale nuk mund të arrihet, pa konsolidimin e një sistemi efektiv të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve dhe se kjo është rruga e vetme e përmbushjes së qëllimeve strategjike të misionit dhe vizionit institucional si dhe pritshmërive të Kuvendit, publikut dhe gjithë palëve të interesit.

KLSH konsideron që, rekomandimet e adresuara përfaqësojnë instrumentet, nëpërmjet të cilave auditimi mund të sjellë një vlerë të shtuar për entitetet publike. Por nuk janë rekomandimet apo pranimi i tyre, faktorët vendimtar që sjellin vlerë të shtuar të veprimtarisë audituese, por janë veprimet e ndërmarra më tej nga subjektet e audituara, për adresimin e rekomandimeve në funksion të arritjes së pritshmërive të synuara. Në këtë këndvështrim efektiviteti i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga KLSH, është mjaft thelbësore për arritjen e përfitimeve maksimale nga veprimtaria audituese.

Kthimi i vëmendjes së Institucioneve Supreme të Auditimit, drejt konsolidimit të mekanizmave dhe politikave efektive të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është një trend global në të gjithë komunitetin e INTOSAI-t.

Në një linjë sa më sipër, për audituesit e KLSH-së, vjen ky dokument mjaft i rëndësishëm, i cili synon të asistojë përdoruesit në implementimin e ndjekjes e zbatimit të rekomandimeve dhe marrjen e rezultateve maksimale nga puna audituese.

Kërkesat e Kornizës së Deklaratave Profesionale të INTOSAI (IFPP) përcaktojnë qartë rolet e përgjegjësitë e subjekteve të audituara dhe Institucioneve Supreme të Auditimit (SAI), sipas të cilave është thelbësore që përgjegjësia për implementimin e rekomandimeve në kohe dhe në mënyrë efektive është e subjekteve të audituara, por nga ana tjetër është përgjegjësi e SAI-ve ndjekja e zbatimit të rekomandimeve pra të verifikojë veprimet e ndërmarra dhe nëse janë arritur rezultatet e pritshme.

Në këtë kontekst, procesi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe inicimi e zbatimi i masave korrigjuese nga subjektet e audituara jep një informacion të detajuar *mbi vlerën e shtuar* që sjell puna e Kontrollit të Lartë të Shtetit dhe njëherazi jep qartazi *garanci* për profesionalizmin, pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit .

Konsolidimi i një mekanizmi efektiv të verifikimit sistematik dhe raportimit të zbatimit të rekomandimeve. bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara i lejon jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj, të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara për

hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.

Procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në KLSH do të sigurohet përmes Regjistrimit Elektronik Institucional, i cili përfaqëson infrastrukturën IT të këtij procesi.

Për të garantuar që informacioni është aktual, audituesit do të përditësojnë në Regjistër statusin e rekomandimeve të hapura gjatë gjithë vitit, në përputhje me afatet e raportimit të tyre nga subjektet e audituara, afate të përcaktuara qartazi në Ligjin Organik të KLSH. Në mënyrë të veçantë, është mjaft i rëndësishëm informacioni i konsoliduar që do të gjenerohet lidhur me rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre sa i takon raportimit periodik që KLSH adreson në Kuvendin e Shqipërisë.

Skemat dhe qasjet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve që trajtohen në këtë manual përfaqësojnë një progres dhe hap përpara për gjenerimin e indikatorëve të konsoliduar institucional, të nivelit të pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve në afatet më të afërta të mundshme që lejojnë përcaktimet e ligjit Organik të KLSH-së, duke mundësuar në këtë mënyrë rritjen e mbikëqyrjes parlamentare nga ana e Kuvendit ndaj ekzekutivit me efekt rritjen e përgjegjshmërisë së menaxhimit të fondeve publike.

Rishikimi i standardeve ndërkombëtare të auditimit për auditimet financiare, të përputhshmërisë, të performancës dhe teknologjisë së informacionit, përmbushja e objektivave të Strategjisë së Zhvillimit të KLSH 2018-2020 në të cilën përcaktohet se *“Efekti real i aktivitetit auditues së KLSH-së matet me nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet publike”* dhe implementimi i rekomandimeve të Komisionit Evropian në kuadrin e proceseve të integritetit evropian të vendit sipas të cilit *“Shqipëria duhet të marrë masa për implementimin në kohë të rekomandimeve të auditimit të jashtëm publik”* e bën të domosdoshëm hartimin dhe implementimin e një metodologjie bashkëkohore që reflekton praktikën më të mirë të fushës dhe në funksion të përmbushjes së objektivave strategjike për modernizimin e institucionit të auditimit të jashtëm publik në Shqipëri.

Kapitulli I. Të përgjithshme

1.1. Qëllimi i manualit

Procedurat për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve kanë për qëllim identifikimin dhe dokumentimin e ndikimit të rekomandimeve në përmirësimin e së veprimitarisë së institucioneve publike. Verifikimi i zbatimit të rekomandimeve përbën padyshim një vlerë të shtuar për performancën e KLSH-së dhe i shërben:

- Qeverisë dhe parlamentit për ndërmarrjen e veprimitarive që synojnë vendosjen para përgjegjësisë të entiteteve publike për iniciimin e veprimeve korrigjuese të propozuara nga KLSH;
- Rritjes së impaktit të veprimitarisë audituese si dhe Vlerësimit të veprimitarisë audituese të KLSH-së;
- Procesit të zhvillimit të kapaciteteve profesionale pasi ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nxjerr në pah nevojën e përmirësimit të njohurive dhe praktikave brenda institucionit të KLSH-se.

Manuali i Ndjekjes të Zbatimit të Rekomandimeve permban parimet, rregullat dhe procedurat, të cilat duhet të zbatohen nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit kur kryejnë ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve nga entitetet publike, si dhe evidentimin e qëndrimit të subjekteve të audituara ndaj rekomandimeve të propozuara nga KLSH.

Manuali synon të jetë një mjet ndihmës për audituesit e KLSH-së në aspektin e rritjes së profesionalizmit të trupës audituese në drejtim të shqyrtimit objektiv të rekomandimeve përkundrejt masave korrigjuese të ndërmarra nga drejtuesit e subjekteve të audituara, çka do t'i shërbejë identifikimit të mangësive, risqeve dhe përmirësimit të procesit auditues. Për këtë qëllim Manuali do të fokusohet në:

1. Metodologjinë e detajuar gjithëpërfshirëse për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, duke mbajtur parasysh dhe integruar specifikat që kanë dhe reflektohen edhe në propozimin e rekomandimeve të auditimeve financiare, të përputhshmërisë, atyre të performancës dhe rekomandimet e auditimeve të teknologjisë së informacionit.
2. Hartimin e një regjistri unik për regjistrimin dhe ndjekjen e rekomandimeve, i cili do të gjenerojë informacion të plotë dhe të detajuar për implementimin e rekomandimeve dhe rritjen e fektivitetit të raportimit mbi zbatimin e rekomandimeve.

1.2. Baza Ligjore

Manuali i Zbatimit të Rekomandimeve Auditimit është hartuar duke u bazuar në:

- × **Kërkesat e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**¹ Neni 163) në të cilat përcaktohet se Kontrolli i Lartë i Shtetit është institucioni që kontrollon veprimtarinë ekonomike të institucioneve shtetërore lidhur me përdorimin dhe mbrojtjen e fondeve publike nga organet e pushtetit qendror dhe vendor, si dhe veprimtarinë ekonomike të personave juridik në të cilët shteti ka më

¹ http://www.klsh.org.al/web/20071109103905_Kushtetuta_e_Republikes_se_Shqiperise_28.pdf

shumë se gjysmën e aksioneve, ose huatë, kreditë dhe detyrimet e tyre garantohen nga shteti.

Neni 164 rregullon detyrimin e KLSH për të raportuar në Kuvendin e Shqipërisë lidhur si më poshtë:

1. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit:

- a) raport për zbatimin e buxhetit të shtetit;
- b) mendim për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar para se të miratohet nga Kuvendi;
- c) informacion për rezultatet e kontrolleve sa here që kërkohet nga Kuvendi.

2. Kontrolli i Lartë i Shtetit i paraqet Kuvendit raportin vjetor të veprimtarisë së tij.

* **Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”² në të cilin përcaktohet:**

Në nenin Neni 15, (pikat a-ç) “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së” përcaktohen detyrimet e KLSH lidhur me:

- Informimin e drejtuesit të njësisë së audituar apo institucioneve të larta për shkeljet e akteve normative me pasojë dëme materiale dhe u rekomandon atyre korrigjimin, rregullimin ose ndryshimin e akteve ligjore;
- Informimin e drejtuesit të njësisë së audituar mbi parregullsitë dhe dëmet financiare gjatë administrimit të fondeve publike dhe t’u rekomandojë atyre që çdo shumë e përdorur në shkelje të ligjeve apo akteve nënligjore të kompensohet dhe të dëmshpërblehet në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji;
- Rekomandimin për drejtuesin e njësisë së audituar apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative;
- Përcjelljen tek organet e posaçme të shqyrtimit administrativ, sipas fushave përkatëse të kompetencës, *gjetjet mbi shkeljet që janë objekt shqyrtimi, së bashku me dokumentet përkatëse të auditimit;*

Në mënyrë specifike në nenin 15 të ligjit organik të KLSH rregullohet mënyra e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në të cilat përcaktohet se:

Pika j “KLSH ka të drejtë të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”;

Pika k “ KLSH ka në drejtë t’u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

² http://www.klsh.org.al/web/ligji_klsh_al_1622.pdf

Neni 30, “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”.

Pika 2 “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Kornizën e Deklaratave Profesionale të INTOSAI-t dhe konkretisht:

× Parimet themelore të INTOSAI-t³

- **INTOSAI-P 1 – Deklarata e Limës e konsideruar si Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit në nenin 11 të saj** “Zbatimi i gjetjeve nga Institucioni Suprem i Auditimit” përcakton që: “Subjekti i audituar duhet të komentojë mbi rezultatet e auditimit, brenda një periudhe kohore të vendosur me ligj, ose nga Institucioni Suprem i Auditimit, dhe duhet të paraqesë masat e marra si rezultat i gjetjeve të auditimit”.

× Parimet kryesore të INTOSAI-t.

Këto parime inkurajojnë Institucionet Supreme të Auditimit jo vetëm që të kenë mekanizma efektivë dhe të përshtatshme për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, por edhe të raportojnë për ndjekjen e masave të marra në kuadrin e zbatimit të këtyre rekomandimeve.

- *Dokumenti i dytë madhor i kornizës së deklaratave profesionale të INTOSAI-t, INTOSAI-P 10 e njohur si “Deklarata e Meksikos mbi Pavarësinë e SAI-ve”, në parimi 7 të saj me titull “Ekzistenca e mekanizmave të ndjekjes së rekomandimeve të SAI-t” theksohet se “Institucioneve Supreme të Auditimit u kërkohet që të kenë sistemin e tyre të brendshme për të ndjekur dhe për t’u siguruar se subjektet e audituara i adresojnë saktë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre dhe sipas rastit këtu përfshihen edhe vërejtjet dhe rekomandimet e bëra nga parlamenti, një prej komisioneve të tij, ose bordi drejtues i subjektit të audituar”.*
- **INTOSAI-P 11 “Ekzistenca e mekanizmave efektivë mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të SAI-t”,** parimi 7 në të cilin përcaktohet se “SAI-et i paraqesin raportet e tyre tek Ligjvënësi, një prej komisioneve të tij, ose një bordi i auditimit të qeverisë, sipas rastit, për rishikimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve specifike, në mënyrë që të ndërmerren veprime korrigjuese.
- SAI-et kanë sistemet e tyre të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, për të siguruar që subjektet e audituara i kanë adresuar saktë vërejtjet, përfshirë ato të bëra nga Ligjvënësi, komisionet e saj apo bordi auditues i qeverisë, sipas rastit”.
- **INTOSAI-P 12, 6-7 “ Vlerat dhe përfitimet e Institucioneve Supreme të Auditimit-të besh diferencën në jetën e qytetarëve”.** Ky parim thekson se: “SAI duhet të ketë një mekanizëm të përshtatshëm për i)

³ <https://www.intosai.org/documents/open-access>, si dhe botimi i KLSH “Standardet ndërkombëtare të auditimit”-2016

ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe ii) për raportimin në mënyrën më të përshtatshme të mundshme për masat e mara për zbatimin e rekomandimeve”.

- **INTOSAI-P 20 “Parimet e transparencës dhe përgjegjshmërisë”**, parimi 3, “SAI-et miratojnë standarde auditimi, procese dhe metoda që janë objektive dhe transparente”.
 - SAI-et kanë mekanizma vijuese efektive për ndjekjen dhe raportimin rekomandimeve për të siguruar që subjektet e audituara duhet të trajtojnë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre, ashtu sikurse bëjnë me ato vërejtje dhe rekomandime të adresuara nga legjislativi (ISSAI 10 mbi parimin e pavarësisë).
 - Procedurat ndjekëse i lejojnë SAI-eve sigurimin e informacionit nga subjekti i audituar mbi masat korigjuuese të ndërmarra ose pse veprimet korigjuuese nuk janë ndërmarrë.

× **Standartet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI**

- **ISSAI 100 “Parimet Themelore të Auditimit në Sektorin Publik”** percakton qartazi rolin monitorues në procesin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve nga SAI dhe konkretisht:
“SAI-et kanë rol në monitorimin e veprimeve të ndërmarra nga pala përgjegjëse në përgjigje të çështjeve të ngritura në raportin e auditimit. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve, përqendrohet në faktin nëse subjekti i audituar ka adresuar në mënyrën e duhur çështjet e ngritura”.
- **ISSAI 300 “Parimet Themelore të Auditimit të Performancës”**, pika 42, trajton me gjerësi stadin e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si pjesë e ciklit të auditimit dhe konkretisht: “Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve i referohet ekzaminimit të veprimit korigjuues të ndërmarrë nga subjekti i audituar, ose një palë tjetër përgjegjëse, në bazë të rezultateve të një auditimit të performancës. Ky është një aktivitet i pavarur që rrit vlerën e procesit të auditimit, duke forcuar ndikimin e auditimit dhe hedhjen e bazës për përmirësime në punën e ardhshme të auditimit. Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve nuk është e kufizuar në zbatimin e rekomandimeve, por përqendrohet në nëse subjekti i audituar ka adresuar problemet dhe evituar situatën themelore në mënyrë adekuate pas një periudhe të arsyeshme kohë”.
- **ISSAI 400 “Parimet Themelore të Auditimit të Përputhshmërisë”**, pika 60, percakton: “Procesi i zbatimit të rekomandimeve lehtëson zbatimin efektiv të veprimeve korigjuuese dhe siguron informacion të dobishëm për subjektin e audituar, përdoruesit e raportit të auditimit dhe audituesin. Për disa SAI, përfshirë dhe gjykatat e llogarive, ndjekja e zbatimit të rekomandimeve mund të përfshijë hartimin e raporteve ligjërish të detyrueshme ose vendimeve gjyqësore. Auditimet e kryera rregullisht për procedurat e zbatimit të rekomandimeve mund të jenë pjesë e vlerësimit të riskut për vitin pasardhës”.

- * **Strategjinë e Zhvillimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit 2018-2022**, e cila ka përcaktuar objektivat konkrete dhe fokusin e KLSH për hartimin e metodologjisë (pika 1.8) dhe ngritjen e zhvillimin e mekanizmave të suksesshme për implementimin dhe ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve. Instrumentet kryesorë që përdor KLSH-ja për realizimin e veprimtarisë gjurmuese të zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera prej tij janë :
 - Ndërtimi dhe implementimi i sistemit të procedurave dhe infrastrukturës e duhur brenda institucionit, për të siguruar gjurmimin sistematik dhe periodik të zbatimit të rekomandimeve.
 - Krijimi i një baze të dhënash për identifikimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit si dhe përdorimin e mjeteve të TI-së në funksion të këtij qëllimi.
 - Forcimi i bashkëpunimit me Kuvendin dhe veçanërisht me Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të KLSH-së, dhe
 - Sinergjizimi me faktorë të tjerë për t'i kërkuar qeverisë të vendosë dhe implementojë urdhra e udhëzime për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së.
- * **Standardet më të mira të fushës** të materializuara në dokumentet e SAI-eve homologe të cilat kanë një nivel të lartë të zbatimit të rekomandimeve, ku një vend specifik dhe të rëndësishëm zë Libri i verdhë i GAO⁵ “*Standardet e Auditimit të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës*”.
- * **Manualet e IDI-t për auditimet financiare, të përputhshmërisë dhe atyre të performancës**⁶.
- * **Rregulloren nr. 107, datë 8 gusht 2017 të Procedurave të Auditimit të KLSH-së**⁷, e ndryshuar.
- * **Rekomandimet e projektit të binjakëzimit IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm”** implementuar në KLSH në periudhën mars 2016- korrik 2018.
- * **Korniza e Matjes së Performancës së SAI-t miratuar në Kongresin e INTOSAI-t Abu Dhabi 2016.**
- * **Vendimi i Kryetarit të Kuvendit, nr. 134/2018 “Për Manualin e monitorimit vjetor dhe periodik”**⁸.

⁴ http://www.klsh.org.al/web/strategjia_zhvillimit_klsh_2018_2022_2_opt_4004.pdf Strategjia e Zhvillimit të KLSH-së 2018 - 2022, Plani Strategjik EUROSAI 2017-2023, Plani Strategjik INTOSAI 2017-2022, viti 2018

⁵ http://www.klsh.org.al/web/standardet_e_gao_1869.pdf

⁶ <https://www.idi.no/en/elibrary/cdp/3i-programme/issai-implementation-handbooks/handbooks-english>

⁷ http://www.klsh.org.al/web/rregullore_e_procedurave_te_auditimit_ne_kontrollin_e_larte_te_shtetit_3332.pdf

⁸ <http://www.parlament.al/Files/Projekte/20181228125634vendim%20nr.%20134,%20dt.%2020.12.2018.pdf>

1.3. Përkufizime

Bazuar në Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, KLSH ushtron veprimtarinë audituese duke u fokusuar në kryerjen e auditimeve financiare, të përputhshmërisë, rregullshmërisë, të performancës dhe auditimeve të teknologjisë së informacionit, si dhe auditimeve të inovacionit e sistemeve. Në referencë të përcaktimeve të bëra në ligjin organik të KLSH por edhe në standartet ndërkombëtare të auditimit këto auditime përkufizohen si më poshtë:

- ✓ **Auditim financiar** është një vlerësim të pavarur, që rezulton në një opinion me siguri të arsyeshme, nëse gjendja e raportuar financiare e një subjekti të audituar, rezultatet dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me kuadrin ligjor të raportimit financiar.
- ✓ **Auditimi i përputhshmërisë** është një proces sistematik i mbledhjes dhe vlerësimit objektiv të evidencës për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara ose gjendja aktuale përputhen me kriteret përkatëse.
- ✓ **Auditim i rregullshmërisë përfshin:**
 - a) verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, i cili përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e të dhënave financiare, si dhe shprehjen e mendimeve për pasqyrat financiare;
 - b) verifikimin e përgjegjësisë financiare të njërive të qeverisjes së përgjithshme;
 - c) auditimin e sistemeve financiare dhe transaksioneve, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret;
 - ç) auditimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik dhe të funksionimit të auditimit të brendshëm;
 - d) auditimin e integritetit dhe përputhshmërisë së vendimeve administrative të marra nga subjekti i audituar, dhe
 - dh) raportimin e të gjitha çështjeve të tjera që dalin nga apo që lidhen me auditimin, të cilat Kontrolli i Lartë i Shtetit i konsideron të rëndësishme për t’u bërë publike.
- ✓ **Auditimi i performancës** është një shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizatave publike, duke iu përmbajtur ekonomicitetit dhe me synim identifikimin e përmirësimeve.
- ✓ **Auditim i IT-së** nënkupton një ekzaminim të zbatimit të sistemeve IT për të siguruar që ato përmbushin nevojat e subjektit të audituar, pa komprometuar sigurinë, privatësinë, koston dhe elemente të tjera kritike të veprimtarisë së subjektit të audituar.
- ✓ **Auditim i inovacionit dhe sistemeve** është procesi me të cilin një auditues kompetent, i pavarur grumbullon dhe vlerëson prova në lidhje me procesin e inovacionit të një subjekti specifik me qëllim raportimin mbi

shkallën e korrespondencës midis procesit të inovacionit dhe praktikave më të mira të njohura në mjedisin e inovacionit.

Inovacioni nënkupton ndryshim dhe ndryshimet në organizata ndodhin përmes projekteve, për rrjedhojë auditimi i inovacionit përfshin:

- a. auditimin e inovacionit dhe sistemeve, me qëllim vlerësimin e ndryshimeve të gjeneruara në përmirësimin e treguese të ekonomicitetit, efektivitetit dhe eficiencës(3E) si rezultat i implementimit të tyre;*
- b. auditimin në terma të performancës të sistemeve të ngritura për të mbëshetur ndryshimin institucional, si dhe projektet reale që sjellin këtë ndryshim;*
- c. auditimin e menaxhimit të ndryshimeve të ndodhura si rezultat i zbatimit të projekteve inovative.*

Rekomandim⁹ - Ndërmarrja e veprimeve që synojnë eliminimin e shkaqeve dhe rezultateve të parregullsisve të konstatuara ose përmirësimin e aktivitetit të njësisë së audituar.

Llojet e rekomandimeve

- × përmirësim ligjor;
- × organizative;
- × shpërblim dëmi¹⁰;
- × administrative;
- × disiplinore;
- × rekomandim për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike (3E);¹¹
- × të tjera sipas specifikave të auditimit (p.sh. të ardhura të munguara).

1.4. Monitorimi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve

- (a) **Pas 20 ditësh¹²**- Plani i zbatimit të rekomandimeve përcjellë në KLSH nga subjekti pas marrjes së raportit të rekomandimeve në të cilin përcaktohen rekomandimi, strukturat përgjegjëse për zbatimin e rekomandimit, afati, fondet e nevojshme, treguesi i rezultateve
- (b) **Pas muajsh 6 muajsh¹³** – Informacioni i hollësishëm i përcjellë nga subjekti i audituar për ecurinë e implementimit të planit të zbatimit të rekomandimeve.

⁹ Fjalori i termave të auditimit

http://www.klsh.org.al/web/glossary_in_albanian_alphabetical_order_4379.pdf

¹⁰ Dëmi ekonomik në aktivitetin auditues i referohet detyrimit të shpërblimit të monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet autoritetit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në çënim të disiplinës financiare dhe kuadrit rregullator përkatës.

¹¹ Efekti negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

¹² Ligji nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Neni 15, pika J

¹³ Ligji nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2

(c) **Auditimi i posaçëm për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve**, i cili ka objektiv vjeljen e informacionit të thelluar për zbatimin e rekomandimeve dhe bazohet në verifikimin në subjektet e audituara, të planit të zbatimit të rekomandimeve pas 20 ditëve dhe informacionin e përcjellë nga subjekti i audituar në KLSH pas 6 muajve. Ky auditim specifik kryhet:

1. Në muajin Janar për rekomandimet e auditimeve të evaduara në gjashtë mujorin e parë të vitit të mëparshëm (p.sh., auditimi i posaçëm kryhet në muajin janar të vitit N+1 për auditimet e evaduara në gjashtë mujorin e parë të vitit N).
2. Në muajin Korrik për rekomandimet e kryera dhe të evaduara në gjashtë mujorin e dytë të vitit të mëparshëm (p.sh., auditimi i posaçëm kryhet në muajin korrik të vitit N+1 për auditimet e evaduara në gjashtë mujorin e dytë të vitit N).
3. Raporti i konsoliduar përfundimtar për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve për vitin e mëparshëm hartohet nga Kontrolli i lartë i Shtetit brenda muajit shtator (për të gjitha rekomandimet e vitit N, raporti i konsoliduar përfundon brenda shtatorit të vitit N+1).

(d) **Auditimi i zbatimit të rekomandimeve në auditimin e radhës**- Në këtë rast verifikimi i zbatimit të rekomandimeve përbën një pikë të veçantë në planin e auditimit dhe procedohet me verifikimin e zbatimit të çdo rekomandimi. Audituesi/it i ngarkuar sipas formularit të ndarjes së detyrave me detyrën e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme pas përfundimit të auditimit dhe dërgimit në subjekt të Raportit Përfundimtar, plotëson dokumentin standard ("Evidencë mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm në subjektin e audituar" (nr 18 sipas përcaktimit në Rregulloren e Procedurave të Auditimit. Dokumenti Standart nr. 18 shërben si bazë për hedhjen e të dhënave në regjistrin elektronik institucional nga Kryeaudituesi i caktuar me detyrën e hedhjes së të dhënave për statusin e zbatimit të rekomandimeve në Regjistrin Elektronik institucional.

(e) **Për auditimet e performancës, procedohet me përcaktimin e afatit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në programin e auditimit.**

1.5. Afati përfundimtar i deklaramentit të statusit të rekomandimit

Ashtu siç është përmendur edhe më sipër, rekomandimet e KLSH-së kanë karakter të ndryshëm, të cilat për vetë specifikat e tyre në disa raste përfshijnë edhe palë jashtë subjektit të audituar. Rast tipik përbën rekomandimi për përmirësim ligjor, i cili në rastin e miratimit të një ligji të ri ose amendimit të pjesëve të veçanta të tij kalon për

shqyrtim në institucione të ndryshme deri në miratimin e tij nga Kuvendi i Shqipërisë.

Rekomandimet që kërkojnë veprime korigjuese që zgjasin në kohë janë edhe rekomandimet e auditimit të performancës të cilat fokusohen tek ekonomiciteti, efienca dhe efektiviteti.

Institucionet moderne të auditimit siç janë Zyra e Auditimit të Qeverisë së SHBA dhe Gjykata Evropiane e Audituesve kryejnë monitorimin e zbatimit të rekomandimeve për një periudhë deri në katër vjet pas përcjelljes në subjekt të raportit të auditimit, kjo pasi nëse rekomandimet nuk janë implementuar gjatë katër viteve ato nuk kanë gjasa të implementohen edhe në vazhdim.

Në kushtet që KLSH përgjithësisht auditimet financiare, të përputhshmërisë, të teknologjisë së informacionit apo të kombinuara i kryen çdo vit për institucionet qendrore dhe 1-2 vjet për subjektet e tjera, për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme të mjedisit ekonomik dhe social dhe me qëllim që rekomandimet të mos humbasin aktualitetin e tyre, **afati përfundimtar i deklaramit të statusit të rekomandimit përcaktohet 3 vjet.**

1.6. Statusi i zbatimit të rekomandimeve

Me synimin e standardizimit të terminologjisë në nivel institucioni dhe konsolidimit të raportimit të performancës institucionale për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit tek subjektet e audituara në vijim gjenden përkufizimet lidhur me statusin e rekomandimeve.

Paraprakisht, një rekomandim i KLSH mund të pranohet ose mund të mos pranohet (të refuzohet) nga subjekti i audituar.

I. Rekomandim i pranuar

Rekomandimi i KLSH-së është shqyrtuar nga subjekti i audituar dhe është përfshirë në planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili duhet t'i jetë dërguar KLSH-së brenda afatit 20 ditor pas përcjelljes së raportit të auditimit, si dhe duhet të jetë informuar KLSH pas afatit 6-mujor mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Në rastet e mungesës së dokumenteve të mësipërme, rekomandimi konsiderohet i pranuar nën arsyetimin që subjekti i audituar nuk ka paraqitur argumente me shkrim për mospranimin e tij.

Rekomandim i papranuar

Në rast se për një ose disa rekomandime, subjekti ka refuzuar me shkrim me shpjegimet përkatëse, audituesi e konsideron rekomandimin/et të papranuar (të refuzuar) nga subjekti. Pra, rekomandimi konsiderohet i papranuar vetëm në rast se subjekti është shprehur me shkrim ose nëpërmjet dokumenteve shkresore të subjektit evidentohet një veprim i tillë.

Për rekomandimet e pranuara, statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuara do të jetë:

- zbatuar plotësisht;
- zbatuar pjesërisht;
- në proces zbatimi;
- pa zbatuar.

a. Rekomandimi është zbatuar plotësisht

Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, subjekti (ose struktura përkatëse brenda subjektit) vërteton zbatimin e rekomandimit sipas llojit (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.)

b. Rekomandimi është zbatuar pjesërisht

Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, subjekti (ose struktura përkatëse brenda subjektit) nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas llojit (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.), si dhe ka pushuar së vepruari në përpjekjen e tij për zbatim.

c. Rekomandimi është në proces zbatimi

Audituesi, mbi bazën e shqyrtimit të dokumentacionit konkludon se brenda afatit të përcaktuar për secilin rekomandim, subjekti (ose struktura përkatëse brenda subjektit) nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimin sipas llojit (përmirësim ligjor, organizativ, shpërblim dëmi, administrativ, disiplinor etj.), por vazhdon përpjekjet për zbatimin e rekomandimit dhe vlerësohet në mundësinë e realizimit.

d. Rekomandimi nuk është zbatuar

Subjekti i auditimit nuk vë në dispozicion të audituesit asnjë dokument që mund të shqyrtohet për të vlerësuar statusin e zbatimit të rekomandimit, edhe pse mund të jetë përfshirë në planin e veprimit.

Gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, shqyrtimi do të bëhet sipas strukturimit të mësipërm në numër masash, si dhe të shprehjes së tyre në vlerë monetare sipas rastit, duke mbajtur vazhdimisht në konsideratë afatin e vendosur për zbatim.

- ✘ ***Në rastin e rekomandimeve për përmirësime ligjore*** (shfuqizimin e një akti/ ndryshimin e tij/ hartimin dhe miratimin e një akti), kur iniciativa është jashtë kontrollit menaxherial të subjektit të audituar, audituesi vlerëson rekomandimin e dhënë për procedurën e ndjekur. Në këtë rast edhe nëse akti ligjor nuk është ndryshuar (përmirësuar) pasi nuk varet nga subjekti, por ka kryer procedurën e nevojshme në një linjë me rekomandimin e KLSH për këtë qëllim, rekomandimi konsiderohet i realizuar.
- ✘ ***Njëlloj dhe për raste të ngjashme të rekomandimeve me karakter organizativ.***
- ✘ ***Në rastin e rekomandimeve për shpërblim dëmi,*** audituesi vlerëson dokumentacionin e nxjerrë nga subjekti i audituar lidhur me procedurën e ndjekur, sipas rekomandimit, duke e shprehur në numër masash dhe vlerën përkatëse sipas statusit tyre. Një rekomandim për shpërblim dëmi vlerësohet

mbi bazën e dokumentacionit vërtetues të lëshuar për procedurën (p.sh., nxjerrjen e urdhrit nga titullari i institucionit për arkëtimin e dëmit, kontabilizimin e vlerës së dëmit e deri të përcjelljen në gjykatë për padisë për arkëtimin e dëmit) dhe jo domosdoshmërisht me arkëtimin e vlerës monetare.

- × **Zbatimi i rekomandimeve për masa administrative** është i lidhur përgjithësisht me veprimin dhe mosveprimin e institucioneve përkatëse ndëshkuese. Në këtë rast, vlerësohet nëse subjekti ka proceduar në një linjë me rekomandimin e KLSH-se, si dhe verifikimin e dokumentacionit të procedurës së ndjekur nga subjekti, ashtu edhe përgjigja e institucioneve përkatëse në se ka ardhur, për shkak të ezuarimit të plotë të masës së rekomanduar.
- × **Për masat disiplinore të rekomanduara** për nëpunësit civil, audituesi shqyrton kalimin e çështjes në komisionin e disiplinës dhe në se ka vepruar ky komision dhe jo domosdoshmërisht me dhënien e masës së rekomanduar. Në rastet e rekomandimeve të masave disiplinore punonjësve, marrëdhëniet e punës të të cilëve rregullohen me Kodin e punës, shqyrtohet drejtpërdrejtë akti i nxjerrë nga titullari për rekomandimin e dhënë (përfshirë ndjekja e procesit gjyqësor nëse çështja midis palëve, kur gjendet për gjykim nga organet e drejtësisë).

Kapitulli II. Metodologjia dhe sistemi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve

2.1. Metodologjia për hartimin e rekomandimeve

Në mënyrë që rekomandimet të merren në konsideratë nga subjekti i audituar dhe të arrijnë impaktin e dëshiruar, audituesi duhet të synojë që rekomandimet të jenë efektive duke propozuar veprime specifike, praktike, me kosto të matshme dhe efektive.

Ato hartohen duke u bazuar në katër elementët e gjetjes të cilat janë:

- ☞ **Kriteret**, të cilat përfshijnë ligjet, rregulloret, kontratat, marrëveshjet e granteve, standardet etj. Kriteret identifikojnë gjendjen ose pritshmërinë e kërkuar ose të dëshiruar në lidhje me aktivitetin e një subjekti të caktuar.
- ☞ **Gjendja**, është një situatë që audituesi gjen gjatë ushtrimit të auditimit.
- ☞ **Shkaku** është faktori ose faktorët përgjegjës për ndryshimin midis gjendjes së identifikuar gjatë ushtrimit të auditimit dhe kriterëve. Gjendja aktuale shërben si bazë për propozimin e rekomandimeve rekomandime dhe veprimeve korigjuese. Faktorët përfshijnë politika ose procedura të mangëta, të hartuara dobët dhe që nuk zbatohen saktë e jo konform kriterëve, siguron një argument të arsyeshëm dhe bindës se pse shkaku i deklaruar është faktori kryesor që kontribuon në ndryshimin midis gjendjes dhe kriterëve.
- ☞ **Efekti** është rezultati ose pasoja që vjen si rrjedhojë e ndryshimi midis gjendjes dhe kriterëve. Efekti mund të përdoret për të demonstruar nevojën për iniciimin dhe implementimin e veprimeve korigjues në përgjigje të devijimeve të konstatuara ose risqeve përkatëse.

Nga analiza e thelluar e katër elementeve të gjetjes (devijimit) të konstatuara, me qëllim përmirësimin e gjendjes, rekomandimet e propozuara duhet:

- të argumentohen dhe rezultojnë nga provat e mbledhura gjatë kryerjes së auditimit;
- të lidhen qartë me objektivat e auditimit dhe katër elementët e gjetjes dhe konkluzioneve;
- të specifikojnë veprimet që duhen kryer nga subjekti i audituar, me kosto efektive dhe të matshme;
- të jenë të mbështetura dhe të argumentuara; dhe
- të adresojnë shkaku/shkaqet e mangësive të identifikuar.

Efektiviteti i veprimtarisë audituese bëhet qartësisht i matshëm nëpërmjet veprimeve korigjuese, hartimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe efektive të ndërmarra nga subjektet e audituara për përdorimin me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike, veprimtari të cilat e kanë burimin e ndryshimit tek rekomandimet e propozuara nga KLSH.

Në funksion të identifikimit të rezultateve të pritshme, pergjate procesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve është parakusht që rekomandimet duhet:

- të jenë qartësisht të orientuara drejt veprimeve korrigjuese;
- të nxisin angazhimin e subjektit të audituar drejt arritjes së rezultateve të pritshme dhe të synuara;
- të krijojnë mekanizma efektiv për monitorimin dhe ndjekjen sistematike të rekomandimeve, të cilat kryejnë një analizë të thelluar për shkaqet e mos zbatimit të rekomandimeve duke hartuar raporte të veçanta që identifikojnë faktorët e brendshëm dhe të jashtëm të mungesës së implementimit të rekomandimeve;
- të kenë një impakt të qenësishëm në rritjen e performances së entiteteve publike në ekonominë, financat, dhe mireqenjen e jetës së qytetarëve.

Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve e bën të domosdoshëm investimin e KLSH-së për ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve me qëllim që të sigurohet:

- **Cilësia e rekomandimeve**- Rekomandimet duhet të jenë të qarta, konkrete dhe rrjedhoje e analizimit të mangësive të konstatuara gjatë auditimit.
- **Sistemi i monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve**- KLSH ndjek një proces efektiv të monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për çdo subjekt të audituar duke u fokusuar në identifikimin e përmirësimeve të bëra si rezultat i punës audituese dhe arritjes së rezultateve të pritshme .
Gjithashtu KLSH siguron ndjekje të vazhdueshme të zbatimit të rekomandimeve dhe evidentimin e tyre në Regjistrin Elektronik të rekomandimeve me qëllim gjenerimin e raporteve me informacione të dobishme për statusin e ndjekjes së rekomandimeve në bazë të nevojave institucionale dhe për efekt raportimi dhe rritjes së mbikqyrjes parlamentare.
- **Vëmendje e veçantë për rekomandimet kryesore**- KLSH duhet të sigurohet që rekomandimet kryesore janë vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe duhet të rivlerësohen strategjitë për të siguruar ndërmarrjen e veprimeve të metejshme. Gjithashtu duhet të vlerësohen dhe të merren në konsideratë edhe faktorë të tjerë jashtë subjektit auditues institucionet e prore në shkallë hierarkike të cilët mund të ndihmojnë në ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme lidhur me implementimin e suksesshëm të rekomandimeve kryesore me rëndësi të veçantë.

2.2 Sistemi i ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve

Kontrolli i Lartë i Shtetit në përmbushje të detyrimit që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe me qëllim informimin e Kuvendit dhe opinionit publik, mbi statusin e zbatimit të rekomandimeve të lëna subjekteve të audituara ndjek një proces efektiv (të përcaktuar në kapitullin III) të monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve për çdo subjekt të audituar duke vënë theksin në

identifikimin e përmirësimeve të bëra si rezultat i punës audituese dhe arritjes së rezultateve për çështje të rekomanduara. Në vetvete procesi i monitorimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve mbështetet nga Regjistri Elektronik i Zbatimit të rekomandimeve, si një bazë të dhënash ku mund të përditësohet dhe aksesohet në kohë reale statusi i zbatimit të një rekomandimi.

KLSH mbështetet mbi baza të qëndrueshme të udhëhequra nga politika menaxheriale për monitorimin dhe ndjekjen e veprimeve të ndërmarra në lidhje me rekomandimet e auditimit, duke u fokusuar në përcaktimin e qartë të procedurave dhe njohjen e stafit me kuadrin respektiv rregullator.

Objektivi kryesor i instalimit të një sistemi efektiv të monitorimit dhe ndjekjes së rekomandimeve fokusohet në dy shtylla kryesore:

- Identifikimi i përmirësimeve për shkak të impaktit të veprimtarisë audituese
- Identifikimi i rezultatit të arritur ndaj rezultatit të pritshëm apo të synuar.

Çdo departament i KLSH-së është përgjegjës dhe i angazhuar për monitorimin e procesit, për të siguruar orientim dhe drejtim në vlerësimin e çdo rekomandimi të lënë në subjektet e audituara dhe për të përgatitur raporte të sakta lidhur me zbatimin e tyre. Në kryerjen e misionit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve audituesi apo grup auditimi i cili ngarkohet me detyren e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve duhet të jetë i angazhuar plotësisht drejt rezultateve, duke konsideruar sa më drejtë veprimet e subjektit të audituar lidhur me zbatimin e rekomandimeve.

Audituesi/grupi i auditimit duhet të ndjekë me korrektësi, dokumentoj me kujdes dhe vlerësojë me profesionalizëm statusin e rekomandimeve të dhëna dhe aktivitetin e subjekteve të audituara në ndjekjen e planit të veprimit të hartuar në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve, duke krijuar një sistem ndjekjeje efektiv dhe të përshtatshëm lidhur me rezultatet që kërkohen të arrihen dhe duke u siguruar që të gjitha rekomandimet janë ndjekur. Në punën e tyre për përcaktimin e statusit të zbatimit të rekomandimit dhe rezultatet e pritshme nga implementimi i rekomandimit, audituesi e mbështet punën e tij në një listë sugjeruese pyetjesh kontrolluese (Aneksi 1) për subjektin e audituar me qëllim evidentimin e qartë të zbatueshmërisë së rekomandimit të dhënë.

Monitorimi aktiv dhe ndjekja e statusit të zbatimit të rekomandimit nga KLSH përfshin: (1) përcaktimin e progresit që po bëhet për zbatimin e rekomandimeve; (2) ndërmarrjen e veprimeve që ndihmojnë subjektin e audituar në zbatimin efektiv të rekomandimeve kur progresi nuk është i mjaftueshëm.

1. Përcaktimi i progresit

Sistemi i ndjekjes të zbatimit të rekomandimeve monitoron statusin e veprimit në të gjitha rekomandimet derisa ato të jenë zbatuar nga subjektet e audituara. Këtij monitorimi i shërben në mënyrë të drejtpërdrejtë Regjistri elektronik i rekomandimeve, i cili përditësohet me informacion sipas afateve të përcaktuara me ligj, por edhe me informacionin e siguruar nga qasjet e tjera aplikuar nga KLSH (p.sh auditimi i posaçëm i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve, auditimi i radhës etj.) i cili gjeneron raporte me informacione të dobishme për statusin e ndjekjes së rekomandimeve. Progresi që pritet varet edhe nga lloji i rekomandimit. Për këtë arsye, një rekomandim qëndron në regjistër me status të hapur për një periudhë deri në 3 vjet. Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve është një përgjegjësi e vazhdueshme dhe statusi i të gjithë rekomandimeve duhet të përcaktohen në baza të planifikuara rregullisht. KLSH përcakton dhe dokumenton statusin e të gjitha rekomandimeve të hapura minimumi **dy herë në vit** përmes procesit të auditimit të posaçëm për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve në muajt Janar dhe Korrik të vitit aktual për rekomandimet e auditimeve respektivisht të 6 mujorit të parë dhe 6 mujorit të dytë të vitit të mëparshëm. Kjo ndihmon për të siguruar që asnjë rekomandim të mos mbetet të mbetet “pa status” ose “status të përditësuar”. Kontrolli i Lartë i Shtetit, i cili vlerësohet se ka një rol të posaçëm në identifikimin e problematikave që lidhen me buxhetin e shtetit dhe performancën e institucioneve publike, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ky manual duhet të përcjellë pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe Ministrisë të Shtetit raporte përmbledhëse çdo katër muaj për rekomandimet e dhëna për subjektet e audituara.

2. Marrja e hapave shtesë për të mundësuar zbatimin e rekomandimeve

Një pjesë tjetër e rëndësishme e ndjekjes është vlerësimi i opsioneve dhe strategjive që mund të ndihmojnë subjektin e audituar për të arritur zbatimin efektiv të rekomandimit kur konstatohet se progresi është i pamjaftueshëm. Kur monitorimi i statusit të zbatimit të rekomandimeve i identifikon rekomandimet si "të pazbatuara", ndjekja e tyre duhet të përcaktojë shkaqet se përse nuk janë ndërmarrë veprime korrigjuese. Grupet e auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, duhet të ndërmarrin hapa shtesë për të verifikuar mospranimet e rekomandimeve ose vështirësitë e implementimit të tyre. Gjithashtu duhet të identifikohen alternativa të rekomandimesh, që të përmbushin objektivat për të cilat është bërë rekomandimi. Nga ana tjetër, mund të bëhet e qartë se mjedisi ka ndryshuar në mënyrë të tillë që problemi nuk ekziston më ose rekomandimi nuk është më i përshtatshëm apo i realizueshëm.

Kapitulli III. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve

3.1. Planifikimi vjetor

Auditimi për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna gjatë auditimeve të kryera në vitin kalendarik të mëparshëm është pjesë e planit vjetor të auditimit të secilit departament auditimi.

Procedurat dhe rregullat e detajuara në këtë manual janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë drejtuesit e departamenteve dhe audituesit në të gjithë ciklin e auditimit për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e evaduara në vitin/vitet e mëparshme.

Auditimi për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve ndjek rrugën si çdo projekt auditimi i zakonshëm me misione të posaçme, me veçoritë e mbulimit vetëm të një fushe të auditimit, numrit të konsiderueshëm të subjekteve nën auditim, si dhe dokumenteve standarde specifike përkatëse.

Për efekt koordinimi të kohës së raportimit të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve sipas detyrimeve kushtetuese dhe kërkesave që burojnë nga rrugëtimi i vendit tonë drejt BE-së, auditimet e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve do të kryhen dy herë në vit. Departamentet e auditimit organizojnë punën për kryerjen e këtij auditimi në muajin janar për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimet e evaduara në gjashtëmuajorin e parë të vitit të mëparshëm dhe në muajin korrik për auditimet e evaduara në gjashtë muajorin e dytë të vitit të mëparshëm. Në këtë mënyrë bëhet e mundur që krahas unifikimit të këtij procesi, KLSH të ketë rezultatet e plota dhe të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve nga auditimet e evaduara vitin e mëparshëm, brenda muajit shtator të vitit në vijim.

Në rastet kur gjatë auditimit të zbatimit të rekomandimeve audituesi has në rekomandime të cilat kanë një afat më shumë se 6 muaj ose në kohën e auditimit subjekti është brenda afatit të zbatimit, grupi i auditimit në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe ecurisë, vlerëson në se rekomandimi realizohet (e konsideron të realizuar); ka nisur por nuk përfundon (realizuar pjesërisht); ose subjekti nuk ka bërë asnjë përpjekje për zbatim e tij dhe nuk ka gjasa për ta nisur veprime për korrigjimin e mangësisë referuar rekomandimit të KLSH-së, duke e konsideruar atë të pazbatuar. Në të gjitha këto raste i rekomandon subjektit të informojë KLSH-në në afatin e përfundimit të implementimit të rekomandimeve të tilla, me qëllim saktësimin dhe përditësimin e tyre.

3.2. Procedura që ndiqet gjatë auditimit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve

Procedurat e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve përshtajnë:

1. Grumbullimin e informacionit ekzistues nga dosja e projektit të auditimit të evaduar për të përcaktuar objektivat dhe pritshmëritë e auditimit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve (shkresa/vendimi e Kryetarit të KLSH-së për rekomandimet që i propozohen subjektit, plani i veprimit i subjektit për zbatimin e rekomandimeve, informacioni për ecurinë e zbatimit;
2. Informacionin për rekomandimet e dhëna nga regjistri elektronik i institucionit, duke përshtatur natyrën dhe llojin e rekomandimit dhe përmban:

- ✘ kërkesa për ndryshim/përmirësim, shfuqizim ose pezullim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi;;
- ✘ rekomandime për masa organizative;
- ✘ rekomandime për shpërblim dëmi¹⁴;
- ✘ rekomandime për masa administrative;
- ✘ rekomandime për masa disiplinore;
- ✘ rekomandime për eliminimin e efektit negativ të përdorimit të fondeve publike (3E);¹⁵
- ✘ të tjera sipas specifikave të auditimit (p.sh. të ardhura të munguara).

Në rastin e kallëzimeve penale, indicieve apo raporteve të auditimit (edhe kur janë pjesore) që i dërgohen organeve të prokurorisë, ndjekja dhe kontrolli i ecurisë së procesit kryhet nga Departamenti Juridik në përputhje me rregullat që parashikon Kodi i Procedurës Penale. Departamenti Juridik mban në një regjistër të veçantë dokumentacionin e ecurisë së hetimit nga prokuroria deri në përfundim të hetimit (duke filluar nga fazat e hetimit, zhvillimit dhe përfundimit të çështjes penale) dhe kalimin në organet gjyqësore për gjykim, krahas regjistrimit elektronik të tyre, sistemit SIIMPA. Për këtë, bashkëpunohet me organet e prokurorisë, duke pasur për bazë dhe referencë pikat e Akt Marrëveshjes së përbashkët, të lidhur ndërmjet KLSH-së dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

Kur çështjet kanë lidhje me padi civile në organet gjyqësore, auditimi i zbatimit të këtyre procedurave ndiqet nga Departamenti Juridik, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile. Departamenti Juridik mban një regjistër të veçantë për vendimet e marra nga organet gjyqësore në të gjitha fazat e gjykimit të çështjes, përkatësisht në Gjykatën e Shkallës së Parë, në Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë dhe sipas rastit deri në Gjykatën Kushtetuese, krahas regjistrimit elektronik të tyre.

3.3. Kryerja e auditimit në subjekt

Drejtorët e Departamenteve të auditimit hartojnë Programin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, dokument që së bashku me Njoftimin (sipas dokumenteve standard), u vihen në dispozicion grupeve të caktuara për realizimin e këtyre auditimeve.

Auditimi i zbatimit të rekomandimeve kryhet sipas drejtimeve të mëposhtme:

- ✘ kontrollin mbi zbatimin e afatit 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve;
- ✘ kërkimin e shpjegimeve nga Titullari i Institucionit të audituar në rast të konstatimit të vonësës në kthimin e përgjigjes jashtë afatit apo shkaqeve mbi moskthimin e përgjigjes;
- ✘ verifikimin e plotësisë dhe saktësisë të programeve të hartuar (plan veprimi ose programi i masave) bazuar në shkresën përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit me rekomandimet, mbërritur në subjektet e

¹⁴ Dëmi ekonomik në aktivitetin auditues i referohet detyrimit të shpërblimit të monetar të një individi ose subjekti që i shkaktohet autoritetit shtetëror të audituar në lidhje me veprime ose mosveprime në çënim të disiplinës financiare dhe kuadrit rregullator përkatës.

¹⁵ Efekti negativ në performancën e subjekteve nën auditim i referohet efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe menaxhimit me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet të fondeve publike.

audituar;

- * vlerësimin e procesit të monitorimit nga Titullari apo personi i autorizuar prej tij (drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm publik dhe/ose nëpunësi zbatues) lidhur me realizimin e programit (plan veprimi ose programi i masave) dhe raportimit në KLSH, të ecursisë së zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit prej 6 muajve nga data e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit.
- * verifikimin e nxjerrjes së akteve administrative përkatëse (urdhrrat), në zbatim të pikës 93, të UMF, nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”* Kapitulli IV, *“Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve”*. Në rast të konstatimit të devijime nga rekomandimet e KLSH-së, vlerësohet niveli dhe ndikimi i tyre në denatyrimin financiar të rekomandimit.

Grupi i auditimit, përpara se të shkojë në subjekt për fillimin e auditimit të ndjekjes të zbatimit të rekomandimeve mbledh dokumentet për secilin subjekt auditimi:

- vendimin e Kryetarit të KLSH-së;
- shkresën përcjellëse të rekomandimeve dërguar subjektit të audituar;
- përgjigjen e subjektit të audituar dhe programin (planin e veprimit) në zbatim të rekomandimeve; dhe
- komunikime të tjera me subjektin në lidhje me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.
- Eksportimin nga Regjistri Elektronik i te dhenave për statusin e zbatimit të rekomandimeve.

Në rastin e urdhrave administrative të lëshuar nga Titullari i subjektit, në lidhje me shpërblimin e dëmit dhe vendimet e gjobave nga personat e ngarkuar me ligj, nga grupi i auditimit verifikohet:

- regjistrimi në kontabilitet i vlerës së shpërblimit të dëmit dhe si është kryer ndjekja e procesit të ndalesave;
- regjistrimi në kontabilitet i vlerës së gjobave të vendosura nga Agjencia e Prokurimit Publik, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, etj., dhe zbatimi i afateve ligjore të nxjerrjes së vendimeve për vjeljen e tyre, duke nxjerrë dhe përgjegjësinë materiale ndaj personave përgjegjës, sipas përcaktimeve të nenit 46 *“Parashkrimi i dënimit administrativ”*, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 *“Për kundërvajtjet administrative”*;
- lëshimi i urdhrave ekzekutiv nga gjykata për vendimet e kundërvajtjes administrative nga gjykata, sipas nenit 24 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, *“Shndërrimi i vendimit për kundërvajtjen administrative në titull ekzekutiv”*.

Grupi i auditimit verifikon dhe dokumenton me kujdes në se janë ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ato ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit dhe vjeljen e gjobave të vendosura, nga Titullari i subjekteve dhe njësia e ngarkuar prej tij. Në rast të verifikimit të kalimit të afateve të parashkrimit ligjor të kërkimit të shpërblimit të dëmit apo pagesave të përfituara tepër, të përcaktuara në nenin 115 të Kodit Civil,

apo nenin 203 të Kodit Punës, për shkak të mosndjekjes në vijimësi nga ana e subjektit të audituar të përcaktohet rast pas rasti përgjegjësia individuale dhe institucionale.

Grupi i auditimit verifikon nxjerrjen e vendimeve për fillimin e procedurave administrative për dhënien e masave disiplinore apo administrative, komunikimin zyrtar personave përkatës, vendosjen në dosjen personale të nëpunësit të vendimit përfundimtar dhe njoftimi për Departamentin e Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, etj. Verifikimet përfshijnë:

- veprimet e strukturës së burimeve njerëzore, përgjegjëse për menaxhimin e nëpunësve, pjesë e shërbimit civil të institucionit, nëse për masat e rekomanduara nga KLSH, ka ndër marrë hapat e nevojshme për krijimin dhe funksionimin e Komisionit Disiplinor, siç parashikohet në Kreun I, neni 10 të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar;
- veprimet e Titullarit të subjektit në cilësinë e eprorit, për marrjen e masave disiplinore sipas rekomandimeve të KLSH-së dhe në zbatim të VKM nr.115, datë 05.03.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor (KD) në shërbimin civil" (në vijim shkurt VKM), duke analizuar:
 - vlerësimin e pretendimeve për shkeljet disiplinore sipas pikës 7, të VKM, si dhe klasifikimi i shkeljeve sipas pikës 9, të VKM dhe pikës 1 të nenit 57 të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013;
 - zbatimin e procedurave për shkelje që klasifikohet të lehta, për masën disiplinore "Vërejtje", parashikuar në nenin 58 pika 2 shkronja (a) të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013.
 - kërkesën ndaj Komisionit Disiplinor që të fillojë ecurinë disiplinore, sipas pikës 10 dhe 11 të VKM apo dërgimin me shkresë zyrtare të kërkesës për ecuri disiplinore pranë organit kompetent, kur shkelja që i adresohet nëpunësit, rezulton se nuk është klasifikuar drejt apo nuk është në juridiksionin lëndor të organit disiplinor që e ka marrë në shqyrtim kërkesën, sipas pikës 12 të VKM.
 - veprimet e Komisionit Disiplinor me marrjen në dijeni për shkeljet disiplinore të rekomanduara nga KLSH (për punonjësit pjesë e shërbimit civil), dokumentimi dhe fillimi i procedurave për ecurinë disiplinore, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit nr.152/2013 datë 30.05.2013, i ndryshuar, dhe VKM nr.115, datë 05.03.2014. Veprimet e eprorit direkt, në rast se marrëdhënia e punës rregullohet me Kodin e Punës, masat disiplinore të parashikuara në kontratën kolektive apo individuale të punës (nenet 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961 datë 12.07.1995 "Kodi i Punës në R.SH", i ndryshuar).

3.4. Raportimi

Rastet e devijimeve trajtohen me kujdes në letrat e punës të audituesit, duke bërë prezent impaktin financiar negativ të këtyre devijimeve, si dhe duke përcaktuar përgjegjësinë ligjore konkrete për zyrtarët dhe punonjësit përkatës të ngarkuar në programin e punës (planin e veprimit) të konfirmuar të Titullarit të subjektit, për zbatimin e rekomandimeve dhe në mungesë të tij, sipas përcaktimeve në shkresën përcjellëse të rekomandimeve.

Audituesit ndjekin me korrektesë, dokumentojnë me kujdes dhe vlerësojnë me profesionalizëm statusin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe aktivitetin e subjekteve të audituara në ndjekjen e planit të veprimit të hartuar në lidhje me zbatimin e këtyre rekomandimeve.

Mbi bazën e kritereve të mësipërme, në përfundim të auditimit të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve bëhet vlerësimi dhe përcaktimi i shkallës së zbatimit të tyre, si më poshtë:

- a. Rekomandimi është zbatuar plotësisht;
- b. Rekomandimi është zbatuar pjesërisht;
- c. Rekomandimi është në proces zbatimi;
- d. Rekomandimi nuk është zbatuar;
- e. Rekomandimi nuk pranohet.

Për rastet e konstatimit të mos zbatimit të rekomandimeve, veçanërisht ato me karakter shpërblim dëmi, për të cilat gjykohet se mosveprimi/et ka ardhur për arsye objektive, grupi auditimit harton një relacion argumentues, i cili nënshkruhet nga anëtarët e grupit të auditimit dhe Drejtori i Departamentit përkatës. Këto rekomandime grupohen në një rubrikë të veçantë të Projektvendimit dhe gjykohen rast pas rasti.

Kur auditimet për zbatimin e rekomandimeve kryhen me program të veçantë për më shumë se një subjekt, grupet e auditimit hartojnë projekt raportin e auditimit për secilin subjekt të audituar.

Raportet Përfundimtare të Auditimit të zbatimit të rekomandimeve dërgohen në subjekte përmes shkresës përcjellëse, dhe bazuar në Vendimin e Kryetarit KLSH-së, subjektit i rikërkohet realizimi i rekomandimeve të pa zbatuara, gjithmonë duke arsyetuar domosdoshmërinë e marrjes së këtyre masave.

Bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, shkronja “k”, “... KLSH, ka të drejtë t’u drejtohet organeve më të larta shtetërore të kompetencës, në rast të moszbatimeve të rekomandimeve të dhëna nga ana e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, përveç rikërkimit për zbatimin e rekomandimeve nga subjektet e audituara, mund t’i drejtohet organeve më të larta shtetërore, me një përmbledhje mbi zbatimin e rekomandimeve.

Në varësi të rëndësisë së rekomandimit, qëndrimit të subjektit dhe nëse gjykohet se mund të rritet ndjeshmëria dhe përgjegjshmëria publike në realizimin e rekomandimeve e paraqitura, adresimi mund të bëhet edhe në drejtime të tjera.

Për çdo rast të konstatimit të mos zbatimit të rekomandimeve të pranuar në mënyrë të pa justifikuar dhe të pa argumentuar, si dhe në rastet e moszbatimit të dispozitave ligjore në përmbushjen e detyrave funksionale, duhet të përcaktohet përgjegjësia individuale e zyrtarëve dhe nëpunësve publikë, të ngarkuar drejtpërsëdrejti me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së si, Titullari i subjektit, Nëpunësi autorizues, Nëpunësi zbatues, Sektori juridik, dhe persona të tjerë të ngarkuar për zbatimin e tyre në programin (planin e veprimit) e subjektit përkatës.

3.5 Raporti i konsoliduar i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve në nivel institucioni

Raporti i Konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e evaduarat gjatë vitit të mëparshëm do të përgatitet brenda muajit **Mars dhe Shtator të çdo**

viti nga Specialisti i Statistikës pranë Drejtorisë së Komunikimit, Botimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në koordinim me Kryeaudituesit dhe Drejtorët e Departamenteve të Auditimit sipas Formatit të Raportit në Aneksin 2 dhe 3.

Drejtorët e Departamenteve të Auditimit, asistuar nga Drejtoria e TI-së, eksportojnë të dhënat nga Regjistri Elektronik i zbatimit të rekomandimeve dhe ia përcjellin ato në formë zyrtare të konfirmuar, Specialistit të statistikës i cili i bën pjesë të Raportit sipas formatit në Aneksin 4.6.

Raporti i Konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve i cili përgatitet në muajin Mars të vitit aktual “N+1” përmban të dhëna të zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera përgjatë gjashtëmuajorit të I (parë) të vitit të mëparshëm (për periudhën Janar-Qershor të vitit “N”). Përmbajtja e Raportit përcaktohet në Aneksin 2.

Raporti i Konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve i cili përgatitet në muajin Shtator të vitit aktual “N+1” përmban të dhëna të zbatimit të rekomandimeve të auditimeve të kryera përgjatë gjithë vitit të mëparshëm (për periudhën Janar-Dhjetor të vitit “N”). Përmbajtja e Raportit përcaktohet në Aneksin 3.

Raportet e Konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme marrin konfirmimin e të gjithë Drejtorëve të Departamenteve, Drejtorëve të Përgjithshëm dhe Sekretarit të Përgjithshëm përpara përcjelljes në Kuvend dhe shoqërohen përkatësisht me shkresën për dërgimin e Raportit (Aneksi 2 dhe 3).

Kapitulli IV. Regjistri elektronik i regjistrimit dhe ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve

4.1. Të përgjithshme

Në këtë kapitull të manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve përcaktohen procedurat që zbatohen nga punonjësit e KLSH-së, si dhe personat e tjerë që kanë ndërveprim me modulën “Regjistri Elektronik i Rekomandimeve” si pjesë të Sistemit të Informacionit të KLSH-së (SIMMPA).

Kjo pjesë e manualit përmban udhëzimet për administrimin, menaxhimin, përpunimin, klasifikimin, përshkrimin, ruajtjen dhe arkivimin e të gjithë bazës së të dhënave të rekomandimeve që regjistrohen në sistemin e informacionit të KLSH-së.

Qëllimi i këtij kapitulli të manualit është përcaktimi i standardeve teknike dhe procedurale, për të siguruar funksionimin e modulit “Regjistri Elektronik i Rekomandimeve” si pjesë e Sistemit të Informacionit për Mbështetjen dhe Menaxhimin e Proceseve të Auditimit (SIMMPA) në KLSH.

Në këtë kapitull përcaktohen:

1. Parimet e përgjithshme dhe masat organizative e teknike për administrimin, përdorimin, mbrojtjen, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave të Regjistrimit Elektronik të Rekomandimeve.
2. Detyrimet dhe të drejtat e përdoruesve që kanë akses në Regjistrin Elektronik të Rekomandimeve.
3. Rregullat dhe detyrimet e ndërsjellta në rastet e mosrespektimit të kërkesave të këtij manuali.
4. Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen me qëllim uljen e rrezikut operacional që mund të shkaktohet nga keqpërdorimi i Sistemit të TIK si edhe të ruajtje besueshmërinë e këtij regjistri në mbështetje të veprimtarisë së trupës audituese të KLSH.

Ky kapitull i manualit i shërben të gjithë përdoruesve të Sistemit të Informacionit për Menaxhimin e Proceseve Audituese në KLSH, të cilët kanë të drejta akses në Regjistrin Elektronik të Rekomandimeve.

Regjistri Elektronik i Rekomandimeve funksionon në përputhje me:

1. Ligjin Nr. 154/2014 ‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit.
2. Rregulloren nr. 58 dt. 30.06.2015 mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
3. Rregulloren nr. 107 dt. 08.08.2017 e ndryshuar mbi Procedurat e Auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit pjesë integrale e të cilës janë Dokumentet Standarde të Auditimit në KLSH.

4. Rregullore nr. 136 dt. 26.09.2018 mbi Funkcionimin e Sistemit të Informacionit të Menaxhimit të Proceseve të Auditimit dhe Administrative Mbështetëse (Revzone) në Kontrollin e Lartë të Shtetit.
5. Politika e Sigurisë së Informacionit në Kontrollin e Lartë të Shtetit nr. 91 dt. 25/07/2018.

Regjistri Elektronik i Rekomandimeve funksionon si kombinim i burimeve njerëzore dhe kompjuterike të KLSH që rezulton në mbledhjen, ruajtjen, rikthimin, komunikimin dhe përdorimin e të dhënave me qëllim të menaxhimit efikas të procesesit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH gjatë projekteve të auditimit, si dhe ofrimin e mundësisë për shpërndarjen e këtij informacioni tek palët e interesit.

Në këtë manual përcaktohen detyrimet, përgjegjësitë, të drejtat dhe niveli i aksesit në të dhëna për çdo përdorues sipas grup-rove përkatës të paracaktuar.

4.2. Regjistri elektronik i rekomandimeve

Regjistri Elektronik i Rekomandimeve është pjesë e Sistemit të Informacionit të Menaxhimit të Proceseve të Auditimit dhe Administrative Mbështetëse dhe ka si funksion ruajtjen, menaxhimin dhe raportimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në institucionet publike të audituara. Regjistri përfshin menaxhimin e integruar në një platformë të vetme të rekordeve të rekomandimeve. Çdo rekomandim do të cilësohet dhe do të trajtohet si një rekord i veçantë në regjistrë, duke krijuar kështu thjeshtësi në raportim dhe një menaxhim të mirë të regjistrit. Regjistri elektronik funksionon si i pavarur nga modulet e tjera të sistemit të informacionit të KLSH, por është i integrueshëm dhe shkëmben informacion me këto module.

Regjistri Elektronik i Rekomandimeve krijon një bazë të dhënash e cila duhet të përditësohet në kohë reale mbi rekomandimet dhe ndjekjen e zbatimit të tyre, duke ruajtur informacionin e nevojshëm për çdo rekomandim me qëllim:

- Planifikimin e duhur të auditimeve.
- Informimin e palëve të interesit (Kuvendi, qytetarët, institucionet homologe, partnerët kombëtare dhe ndërkombëtare).
- Ruajtjen e konfidencialitetit, disponueshmërisë dhe integritetit të të dhënave.
- Raportimin në bazë të nevojave institucionale.

Informacioni i ruajtur për çdo rekomandim përmban:

- Numrin identifikues të rekomandimit;
- Subjekt in/et për të cilin është dhënë rekomandimi;
- Departamentin e auditimit i cili ka dhënë rekomandimin;
- Datën e fillimit të projektit të auditimit në konkludim të të cilit është dhënë rekomandimi;

- Datën e mbarimit të projektit të auditimit në konkludim të të cilit është dhënë rekomandimi;
- Datën e fillimit të periudhës së audituar;
- Datën e mbarimit të periudhës së audituar;
- Nr. Vendimit për dhënien e rekomandimit;
- Datën e Vendimit për dhënien e rekomandimit;
- Llojin e rekomandimit;
- Gjetjen;
- Rekomandimin;
- Vlerën (në rastet e rekomandimeve që lidhen me dëme ekonomike);
- Afatin e zbatimit të rekomandimit (Datë fillimi);
- Afatin e zbatimit të rekomandimit (Datë mbarimi);
- Paraqitur ose jo plan-veprimi pas 20 ditësh (Numri i protokollit dhe data e shkresës përkatëse);
- Paraqitur ose jo informacion mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit pas 6 muajsh (Numri i protokollit dhe data e shkresës përkatëse);
- Statusin aktual të zbatimit të rekomandimit.

Gjatë menaxhimit dhe administrimit të procesit të auditimit përmes sistemit të informacionit të KLSH-së, SIMMPA, grupi i auditimit ashtu sikurse dikton rregullorja e procedurave të auditimit, pas miratimit nga Kryetari i KLSH-së te dokumentit standard Nr. 15 të procedurave të auditimit të KLSH, ‘**Vendim**’ Pergjegjesi i Grupit te Auditimit plotëson në një menu të veçantë **një nga një të gjithë gjetjet** dhe rekomandimet e auditimit, (nuk lejohet hedhja e Vendimit ne versionin bashkelidhur) të cilat i dërgohen subjektit të audituar në formë rekomandimi.

Gjatë plotësimit të fushave përkatëse të rekomandimeve në sistem, audituesi plotëson të dhënat e mëposhtme:

- Gjetja
- Rekomandimi
- Lloji i rekomandimit
- Afati i zbatimit të rekomandimit

Pas plotësimit të rekomandimeve në këtë menu, të Vendimit te miratuar nga Kryetari i KLSH, audituesi duhet të japë në sistem komandën për të kaluar automatikisht rekomandimet nga projekti i auditimit tek regjistri elektronik i rekomandimeve. Audituesi mund ta kryejë këtë veprim duke përzgjedhur të gjithë rekomandimet dhe duke i kaluar të gjithë rekomandimet dhe gjetjet njëkohësisht “me 1 klikim” ose mund të zgjedhë ti kalojë një nga një gjetjet dhe rekomandimet nga projekti i auditimit në regjistrin elektronik të rekomandimeve.

Rekordi i gjetjes dhe rekomandimit përkatës, në momentin e regjistrimit në sistem nga audituesi gjatë projektit të auditimit merr një numër unik identifikimi (ID) me të cilin edhe regjistrohet në bazën e të dhënave. E njëjta gjë vlen edhe për Regjistrin Elektronik të Rekomandimeve. Në momentin që audituesi kalon në sistem rekomandimet dhe gjetjet nga projekti i auditimit tek Regjistri Elektronik i Rekomandimeve, ato pajisen në regjistër me një numër unik identifikimi. Ky numër unik do të shërbejë për të identifikuar rekomandimin gjatë të gjithë ciklit jetësor të tij.

Të dhënat e sipërpërmendura të cilat plotësohen nga audituesit gjatë një projekti auditimi, do të plotësohen automatikisht dhe në rekordet përkatës të rekomandimeve në regjistrin elektronik të rekomandimeve.

Regjistri Elektronik i Rekomandimeve është i pozicionuar në menunë “Procese” □ ‘Procese KLSH’ □ ‘Ndjekje e zbatimit të rekomandimeve’ sikurse paraqitet në Aneksin 4.1.

Në gridën kryesore shfaqen rekordet për të gjithë rekomandimet e regjistruar në regjistrin elektronik të rekomandimeve sikurse demonstron në Aneksin 4.2. Secili rekomandim që gjendet në regjistër përbën një rekord të veçantë, duke ofruar kështu mundësinë e trajtimit (përditësimit) të çdo rekomandimi të pavarur nga rekomandimet e tjerë.

Në klikim të një rekomandimi përdoruesit i shfaqen në një dritare të re të gjithë detajet e ruajtura në bazën e të dhënave, për rekomandimin e klikuar. Në këtë ndërfaqje, e cila paraqitet në Aneksin 4.3, përdoruesi i cili ka të drejta për përditësimin/ndryshimin e të dhënave të rekomandimeve, mund të bëjë ndryshimet që ai kërkon.

I gjithë informacioni që i paraqitet përdoruesit në lidhje me rekomandimin është konform fazës aktuale në të cilin gjendet rekomandimi përgjatë ‘ciklit jetësor’ të tij.

Regjistri Elektronik i Rekomandimeve është i aksesueshëm edhe nga versioni web i sistemit të informacionit të KLSH-së gjë e cila mundëson edhe përditësimin e regjistrit në distancë.

4.2.1. Rrjedha logjike e informacionit, ndërveprimi i përdoruesve për përditësimin e regjistrit gjatë ciklit jetësor të rekomandimeve dhe raportimi

Cikli jetësor i një rekomandimi në regjistrin elektronik të rekomandimeve rrjedh sipas një logjike dhe ndjek një proces të mirë përcaktuar në përputhje me rregulloren e procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit dhe me cilësimet e këtij manuali. Rrjedha logjike që ndjek rekomandimi përgjatë ciklit të tij jetësor paraqitet në Aneksin 4.4. Rrjedha logjike e informacionit mund të ndryshohet vetëm me Urdhër të Kryetarit të KLSH-së.

4.2.1.1 Përshkrimi i ciklit jetësor të rekomandimit

Në momentin që përgjegjësi i grupit të auditimit zgjedh opsionin përkatës në një projekt auditimi, për të kaluar rekomandimin në regjistrin elektronik të rekomandimeve, automatikisht ky rekomandim fillon ciklin e tij jetësor në regjistër. Ai regjistrohet në regjistër me të gjithë informacionet dhe të dhënat përkatëse të tij dhe rezulton në fazën 1 (Regjistrim i rekomandimit) të ciklit jetësor të ndjekjes së zbatimit të tij.

Në bazë të rregullores së procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, subjekti i audituar, brenda 20 ditëve nga momenti i përcjelljes nga KLSH i Raportit Përfundimtar dhe Vendimit Përfundimtar, duhet të paraqesë pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit, një program për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga projekti i auditimit për të cilin është dërguar Raporti Përfundimtar dhe Vendimi.

20 ditë pas dërgimit në subjekt të Raportit Përfundimtar dhe Vendimit, KLSH ka një përgjigje nëse subjekti ka paraqitur program veprimi ose jo dhe nëse rekomandimi është pranuar ose jo. Në këtë moment rekomandimi bën një hap tjetër në ciklin jetësor të tij, duke pasur dy shtigje të ndryshme për të kryer këtë hap, drejtimi i të cilëve varet nga paraqitja ose jo e një programi nga subjekti i audituar dhe pranimi ose jo i rekomandimit të lënë nga KLSH.

- a. Në rast se subjekti paraqet pranë KLSH-së një program për zbatimin e rekomandimit, dhe në këtë program cilësohet se rekomandimi është pranuar, ose në rast se subjekti nuk paraqet pranë KLSH-së një program për zbatimin e rekomandimeve, ky i fundit kalon në fazën pasardhëse (Statusi i rekomandimit pas 20 ditësh) dhe progresi i tij në procesin që ndiqet deri në zbatimin e tij, avancon.
- b. Në rast se subjekti paraqet pranë KLSH-së, një program për zbatimin e rekomandimit, dhe rekomandimi cilësohet si i pa pranuar nga subjekti, ky i fundit përfundon ciklin e tij jetësor dhe arkivohet me status 'Pa Pranuar'.

Rekomandimet që ndjekin shtegun 'a' dhe që kanë status aktual 'Pranuar', mbajnë këtë status deri në 6 muaj pas përcjelljes në subjekt të raportit përfundimtar të auditimit, afat kur sipas rregullores së procedurave të auditimit në Kontrollin e Lartë të Shtetit, subjekti i audituar duhet të paraqesë pranë KLSH planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi..

6 muaj pas përcjelljes në subjekt të raportit përfundimtar të auditimit, rrjedha logjike e ciklit jetësor të rekomandimeve që në afatin 20-ditor morën shtegun 'a' ndjek tre shtigje të mundshme.

- a.1. Subjekti i audituar paraqet plan veprimi për rekomandimin e pranuar dhe progresi i rekomandimit avancon.
- a.2. Subjekti i audituar nuk paraqet plan veprimi për rekomandimin e pranuar dhe progresi i rekomandimit nuk avancon.

a.3. Subjekti i audituar paraqet plan veprimi për rekomandimin në të cilin rekomandimi cilësohet me status ‘Pa Pranuar’ dhe rekomandimi cilësohet si i pa pranuar nga subjekti duke përfunduar kështu ciklin jetësor dhe duke u arkivuar me status “Pa Pranuar”.

Rekomandimet të cilët ndjekin shtegun a.1., pas vlerësimit në misionet e auditimit të ardhshme apo në misionet e auditimit të dedikuara për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve, mund të marrin tre shtigje (statuse) të ndryshëm.

a.1.1 Rekomandimi pas vlerësimit nga grupi i auditimit cilësohet me status ‘Pa Zbatuar’.

a.1.2 Rekomandimi pas vlerësimit nga grupi i auditimit cilësohet me status ‘Në proces zbatimi’ ose ‘Zbatuar pjesërisht’.

a.1.3 Rekomandimi pas vlerësimit nga grupi i auditimit cilësohet si i zbatuar nga subjekti. Në këtë rast rekomandimi përfundon ciklin e tij jetësor dhe arkivohet me status ‘Zbatuar’.

Rekomandimet të cilët ndjekin shtegun a.1.1., pas vendimarrjes nga ana e Kryetarit të KLSH-së kanë dy shtigje të mundshme për vijimin e ciklit të tyre jetësor.

a.1.1.1 Rekomandimi, pas vendimarrjes nga ana e Kryetarit të KLSH-së, ri-adresohet për zbatim nga ana e subjektit të audituar dhe rifillon ciklin jetësor nga fillimi duke kaluar në fazën 1. ‘Regjistrimi i rekomandimeve’. Në këtë rast, auditimi ri-pajiset me një numër të dytë identifikimi për të treguar se ai është një rekomandim i ri-adresuar.

a.1.1.2 Rekomandimi, pas vendimarrjes nga ana e Kryetarit të KLSH-së, nuk ri-adresohet për zbatim nga ana e subjektit të audituar dhe përfundon ciklin e tij jetësor dhe arkivohet me status ‘Pa Zbatuar’.

Rekomandimet të cilët ndjekin shtegun a.1.2. pas vendimarrjes nga ana e Kryetarit të KLSH-së kanë dy shtigje të mundshme për vijimin e ciklit të tyre jetësor.

a.1.2.1 Rekomandimi, pas vendimarrjes nga ana e Kryetarit të KLSH-së, ri-adresohet për zbatim nga ana e subjektit të audituar dhe rifillon ciklin jetësor nga fillimi duke kaluar në fazën 1. ‘Regjistrimi i rekomandimeve’. Në këtë rast, auditimi ri-pajiset me një numër të dytë identifikimi për të treguar se ai është një rekomandim i ri-adresuar.

a.1.2.2 Rekomandimi, pas vendimarrjes nga ana e Kryetarit të KLSH-së, nuk ri-adresohet për zbatim nga ana e subjektit të audituar dhe përfundon ciklin e tij jetësor dhe arkivohet me status ‘Zbatuar pjesërisht/Jo-riadresuar’ ose ‘Në proces zbatimi/Jo-riadresuar’.

4.2.2 Përgjegjësitë dhe të drejtat në lidhje përditësimin e regjistrin të rekomandimeve dhe statusit të rekomandimeve sipas fazave të ciklit jetësor të rekomandimit

Baza e të dhënave e regjistrin elektronik të rekomandimeve furnizohet me të dhëna nga projektet e auditimit dhe popullohet automatikisht duke përdorur këto të dhëna. Të drejtën për të populluar manualisht regjistrin elektronik të rekomandimeve me rekomandime të reja e ka vetëm Kryeaudituesi i departamentit të auditimit. Gjatë menaxhimit të projektit të auditimit përmes sistemit SIMMPA, përgjegjësi i grupit të auditimit, pas miratimit nga Kryetari të Dokumentit Standard 15 (Vendim Përfundimtar i Auditimit) kalon automatikisht në regjistër, rekomandimet e plotësuar në sistem sipas fushave përkatëse të formatit të dokumentit standard 15, 'Vendim'. Mënyra e kalimit të rekomandimeve nga projekti i auditimit në regjistrin elektronik të rekomandimeve paraqitet në Aneksin 4.5.

Në rast se përgjegjësi i grupit të auditimit nuk e kryen procesin e kalimit të rekomandimeve të lëna gjatë auditimit në regjistrin elektronik të rekomandimeve, të drejtën për t'i regjistruar manualisht rekomandimet në regjistër e ka vetëm Kryeaudituesi i departamentit. Nga momenti i regjistrimit të një rekomandimi në regjistrin elektronik të rekomandimeve, përgjegjësi dhe audituesit e grupit të auditimit nuk kanë më akses për ta modifikuar/fshirë atë në regjistër.

Pas regjistrimit në regjistrin elektronik të rekomandimeve, çdo rekomandim do të kalojë një cikël jetësor të tijin siç paraqitet në Aneksin 4.4.

Të drejtat dhe përgjegjësitë e përdoruesve të regjistrin elektronik të rekomandimeve në secilën prej fazave të rrjedhës logjike të ciklit jetësor të një rekomandimi janë si më poshtë vijon :

**** Regjistrimi i Rekomandimit***

Kjo fazë ezaurohet duke u plotësuar me të dhëna të cilat burojnë nga projektet e auditimit, në përfundim të të cilëve përgjegjësi i grupit të auditimit furnizon me të dhëna regjistrin elektronik të rekomandimeve. Është përgjegjësi e përgjegjësit të grupit të auditimit për të kryer këtë proces.

Të drejtën për të shtuar manualisht rekomandime në regjistër e ka vetëm **1** Kryeaudituesi i departamentit i cili caktohet nga drejtori i departamentit.

Kryeaudituesi i departamentit do të ketë mundësinë e aksesimit dhe përditësimit të rekordeve vetëm në ato rekomandime që i përkasin departamentit në të cilin ai bën pjesë.

**** Statusi i rekomandimit pas 20 ditësh***

Në zbatim të pikës 'j' të Nenit 15, të Ligjit Nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", subjekti i audituar duhet të paraqesë

pranë KLSH-së, një program veprimi për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH në përfudim të auditimit.

Informacioni nëse subjekti i audituar ka paraqitur program pranë KLSH në lidhje me rekomandimet e lëna nga auditimi duhet të pasqyrohet në regjistrin elektronik të rekomandimeve, veprim i cili kryhet nga Kryeaudituesi i departamentit për të gjithë rekomandimet e lëna gjatë auditimeve të kryera nga departamenti pjesë e të cilit ai është, duke vendosur statusin sipas trajtimit në pikën 1.6 “Statusi i zbatimit të rekomandimeve”.

Përveç informacionit nëse është paraqitur ose jo program për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, Kryeaudituesi i departamentit duhet të plotësojë edhe informacionin nëse rekomandimet janë pranuar ose jo nga subjekti i audituar.

Pra, është përgjegjësi e Kryeaudituesit të departamentit të përditësojë në regjistrin elektronik të rekomandimeve statusin e rekomandimeve 20 ditë pas marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit nga njësia e audituar.

*** Statusi i rekomandimit pas 6 muajsh.**

Bazuar në Ligjin Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, brenda 6 muajve nga data e marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit, njësia e audituar duhet t’i raportojë Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Është përgjegjësi e Kryeaudituesit të departamentit të përditësojë në regjistrin elektronik të rekomandimeve statusin e rekomandimeve, 6 muaj pas marrjes së Raportit Përfundimtar të Auditimit nga njësia e audituar.

Kryeaudituesi, si në përditësimin e statusit të rekomandimit pas periudhës 20-ditore ashtu edhe në përditësimin e statusit të rekomandimit pas periudhës 6-mujore është i detyruar të plotësojë në regjistrin elektronik të rekomandimeve informacionin protokollar (numrin e protokollit dhe datën e shkresës përkatëse) me të cilin KLSH është informuar nga njësia e audituar.

*** Statusi i rekomandimit pas auditimit të zbatimit të rekomandimeve.**

Bazuar në Ligjin Nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, pas periudhës 6-mujore të përmendur në pikën e mësipërme, KLSH mund të ndërrmarë misionet për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Në përfundim të auditimeve të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme, grupi i auditimit konkludon mbi statusin final të rekomandimit duke

përcaktuar nëse rekomandimi është zbatuar, është zbatuar pjesërisht ose nuk është zbatuar.

Është përgjegjësi e Kryeaudituesit të departamentit përditësimi i statusit final të rekomandimeve në regjistrin elektronik të rekomandimeve.

Rekomandimet të cilët marrin statusin final 'Zbatuar' arkivohen dhe ndalohet aksesimi për ndryshim apo përditësim të mëtejshëm të tyre. Ndërkohë për rekomandimet të cilët marrin statusin final 'Zbatuar pjesërisht' ose 'Pa zbatuar' kalojnë në një fazë pasardhëse bazuar në Vendimin e Kryetarit (në të cilin përcaktohet ri adresimi dhe një here subjektit i rekomandimeve) që rezultojnë në përfundim të auditimit të zbatimit të rekomandimeve (auditim i posaçëm apo auditim i radhës)

4.2.3 Të drejtat dhe përgjegjësitë e përdoruesve

Përdoruesit e brendshëm të regjistrin elektronik të rekomandimeve të KLSH-së përfshijnë të gjithë punonjësit e institucionit që shfrytëzojnë dhe përdorin këtë regjistrin dhe të dhënat që ndodhen në të për të kryer proceset e punës së tyre. Përdoruesit e brendshëm përfshijnë të gjitha nivelet e punonjësve:

- ✦ Punonjës të nivelit të lartë menaxherial, sipas përcaktimeve të ligjit të KLSH-së dhe akteve nënligjore janë përgjegjës për hartimin e ndjekjen e strategjive, planeve dhe politikave të përgjithshme të institucionit.
- ✦ Trupa audituese që është përgjegjëse për ndjekjen e proceseve që realizojnë ekzekutimin e projekteve të auditimit të miratuar nga niveli menaxherial si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar.
- ✦ Punonjësit e strukturave mbështetëse që janë përgjegjës për ndjekjen e proceseve mbështetëse të institucionit në përputhje me rregulloren e brendshme dhe përcaktimeve të përshkrimeve të punës si dhe si dhe çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga instancat superiore.

4.2.3.1 Përgjegjësitë e përdoruesve të sistemit SIMMPA

Përdoruesit e regjistrin elektronik të rekomandimeve gjatë përdorimit të modulit duhet të respektojnë Kodin Etik të KLSH dhe legjislacionin mbi arkivat dhe dokumentin elektronik. Me anë të këtij manuali përdoruesve u cilësohet se atyre nuk u lejohet të kopjojnë dhe përdorin pjesë të softuerit të mbrojtur me të drejtën e autorit pa autorizimin e duhur.

Përdoruesit nuk mund të përdorin kompjuterët dhe regjistrin elektronik të rekomandimeve të KLSH për aktivitet biznesi, profesional, personal ose tjetër që nuk ka lidhje me qëllimin e këtij regjistri.

Përdoruesit e sistemit janë përgjegjës për mbrojtjen e kredencialeve të llogarisë së tyre në sistem. Aksesimi i llogarisë personale të përdoruesve nuk duhet të ndahet me askënd, ose me dashje të lejohet aksesimi paautorizuar, privilegje apo të drejta në sistem për individë që nuk kanë llogari personale në sistem. Nëse zbulohet ndarja ose

aksesi i paautorizuar, llogaritë përkatëse të përdoruesve që janë të përfshirë në të, do të kryhet çaktivizimi dhe zbatohen sanksionet sipas dispozitat e ligjeve në fuqi.

Çdo punonjës i KLSH që ka akses në regjistrin elektronik të rekomandimeve, përmes këtij manuali orientohet të raportojë shkeljet e mundshme të sigurisë sa më shpejt që të jetë e mundur tek Drejtuesi i njësise përgjegjëse të teknologjisë së informacionit apo administratorët e sistemit.

Çdo përdorues i sistemit ka përgjegjësi për t'u siguruar që të dhënat e tij personale janë të regjistruara saktë në sistem. Nëse përdoruesi konstaton pasaktësi në të dhënat e tij (emri, mbiemri, adresa e emailit etj.) ai duhet të njoftojë Drejtorin e Drejtorise të TI-së ose administratorët e sistemit përmes postës elektronike.

4.2.3.2 Të drejtat e përdoruesve në regjistër

Të drejtat e përdoruesve në regjistrin elektronik të rekomandimeve përshkruhen në këtë manual dhe zbatohen në praktikë bazuar në nivelet strukturale të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Për arsye se struktura organizative e institucionit mund të jetë subjekt i ndryshimeve të vazhdueshëm, në këtë manual përcaktohet se në përputhje me ndryshimet e mundshme strukturore duhet të pasqyrohen edhe ndryshimet në të drejtat e përdoruesve sipas ndryshimeve strukturore të bëra. Ky veprim kryhet nga administratorët e sistemit vetëm pasi ata njoftohen me shkrim nga Kryetari/Sekretari i Përgjithshëm apo Drejtoria e Burimeve Njerëzore.

Të drejtat e përdoruesve në regjistër sipas niveleve strukturore paraqiten në matricën e mëposhtme:

Procesi i ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve																				
Grupet/Rolet	Regjistrimi i rekomandimit në regjistër				Statusi i rekomandimit pas 20 ditësh				Statusi i rekomandimit pas 6-muajsh				Statusi i rekomandimit pas auditimit të ri				Rekomandim të ri / anulim të rekomandimit			
	Krijon	Përpunon	Lexon	Miraton	Krijon	Përpunon	Lexon	Miraton	Krijon	Përpunon	Lexon	Miraton	Krijon	Përpunon	Lexon	Miraton	Krijon	Përpunon	Lexon	Miraton
Kryetar			✓				✓				✓				✓	✓			✓	✓
Sekretar I Përgjithshëm																				
Drejtor i Përgjithshëm			✓				✓				✓				✓				✓	
Drejtor Departamenti			✓								✓				✓				✓	
Drejtor Drejtorie			✓								✓				✓				✓	
Kryeauditues	✓	✓	✓		✓	✓	✓		✓	✓	✓		✓	✓	✓		✓	✓	✓	
Auditues (Në cilësinë e Përgjegjës të grupit)	✓																			
Jurist në Departament																				
Protokollist/Arshivist																				
Përgjegjës Sektori IT																				
Përgjegjës Sektori Financës																				
Specialist IT																				
Specialist Finance																				
Drejtor I Burimeve Njerëzore																				
Drejtor I Metodologjisë																				
Drejtorja e Marrëdhënieve me Jashtë																				
Specialist Statistikash			✓				✓				✓				✓				✓	
Drejtor i Departamentit Juridik																				
Jurist në Departament Auditimi																				
Administrator	✓	✓	✓		✓	✓	✓		✓	✓	✓		✓	✓	✓		✓	✓	✓	

4.2.3.3 Niveli i aksesit që kanë përdoruesit në sistem

Vetëm përdoruesve të autorizuar u jepet akses në regjistrin elektronik të rekomandimeve si pjesë e sistemit të informacionit të KLSH dhe përdoruesit janë të kufizuar në veprimtarinë që ata mund të kryejnë në aplikacion. Kontrolli i aksesit në regjistrin arrihet përmes ID-ve të përdoruesit që janë unike për çdo përdorues individual për të siguruar llogaridhënie individuale.

Niveli i aksesit nga përdoruesit e brendshëm, është i vlefshëm dhe zbatohet si për të gjitha komponentët e Sistemit të Informacionit të KLSH.

Të gjithë përdoruesit e regjistrin elektronik të KLSH-së mund të aksesojnë regjistrin duke përdorur aksesin e aprovuar të përcaktuar në këtë manual dhe në rregulloren e funksionimit të sistemit SIMMPA. Përdoruesit mbajnë përgjegjësi për të gjitha veprimet e kryera nga llogaria e tyre në sistem.

Kontrollet e aksesit do të zbatohen për të gjithë informacionin e regjistrin bazuar në klasifikimin e të dhënave të tij për të siguruar që informacioni nuk zbulohet, modifikohet, fshihet ose bëhet i padisponueshëm në mënyrë të paligjshme.

Miratimi për akses në regjistrin nuk do t'i jepet asnjë përdoruesi pa miratimin e duhur. Punonjësit menaxherial duhet të njoftojnë administratorin e sistemit në mënyrë elektronike dhe të raportojnë të gjitha ndryshimet e rëndësishme në detyrat e përdoruesit fundor, nivelin e aksesit të tij ose në statusin e punësimit.

Aksesi i përdoruesit duhet të bllokohet menjëherë nëse individit i komunikohet pezullimi apo ndërprerja e marrëdhënieve të punës. Përveç kësaj, privilegjet e përdoruesve duhet të ndryshohen në mënyrë të përshtatshme nëse punonjësi transferohet në një pozicion pune të ndryshëm. Ky ndryshim kryhet nga administratori i sistemit pas njoftimit me anë të e-mail dhe shkresës nga ana e Drejtorisë së Burimeve Njerezore.

Gjurmët e Auditimit dhe Logimi janë të bazuara në Klasifikimin e të Dhënave të Sistemeve.

Aksesimi i regjistrin do të regjistrohet dhe auditohet në një mënyrë që lejon të regjistrohet:

- koha e aksesimit;
- llogaria e përdoruesit;
- metoda e aksesimit;
- të gjitha komandat që llogaria e përdoruesit kryen;

✓ **Aksesi i paautorizuar:** Punonjësit janë të ndaluar të kryejnë akses të paautorizuar në regjistrin elektronik të KLSH-së ose të dëmtojnë, ndryshojnë ose prishin operacionet dhe informacionet e regjistrin.

✓ **Aksesi në distancë:** Aksesi në distancë duhet të përputhet me të paktën minimalisht të gjitha kërkesat ligjore dhe me politikën menaxheriale të KLSH.

4.2.3.4 Të drejtat dhe përgjegjësitë e administratorit

KLSH përcakton kërkesa specifike për mbrojtjen e informacionit dhe sistemit SIMMPA nga ndërhyrjet e paautorizuara. Edhe regjistri elektronik i rekomandimeve, si pjesë integrale e këtij sistemi përcakton të njëjtat kërkesa.

Rregullat dhe procedurat e kontrollit të aksesit nevojiten për rregullimin se kush mund të aksesojë regjistrin elektronik të rekomandimeve dhe privilegjet përkatëse të aksesit. Kjo politikë aplikohet në çdo kohë dhe duhet të respektohet nga çdokush që akseson informacionet e sistemit së të çfarëdolloj formati dhe në çfarëdolloj pajisje.

Regjistri elektronik i rekomandimeve të KLSH-së i cili përdor procedura të sigurta autentifikimi, për menaxhimin e përdoruesve është konfiguruar për të siguruar sa më poshtë:

- Autentifikimin e përdoruesve individual, jo grup përdoruesish – p.sh. jo llogari të përgjithshme;
- Mbrojtje lidhur me tërheqjen e fjalëkalimeve dhe detajeve të sigurisë;
- Ruajtje dhe monitorim të aksesit në regjistrin – në nivel përdoruesi;
- Menaxhimin e roleve në mënyrë që funksionet të mund të realizohen pa patur nevojën e dhënies së fjalëkalimeve;
- Proceset e administrimit të fjalëkalimit duhet të kontrollohen, sigurohen dhe auditohen siç duhet.

Për administrimin teknik të bazës së të dhënave të regjistrin elektronik të rekomandimeve të KLSH-së është përgjegjës Drejtorja e IT-së.

✓ Kontrolli i aksesit

Për çdo akses në informacionin e regjistrin të rekomandimeve në KLSH, personelit do ti jepet akses vetëm në përputhje me funksionet e tyre për kryerjen e detyrave dhe ky akses do të kontrollohet me rreptësi për të ruajtur integritetin dhe sigurinë.

Çdo përdorues i regjistrin elektronik të rekomandimeve (brendshëm apo i jashtëm), kontraktues ose konsulent, duhet të identifikohet në mënyrë individuale nëpërmjet një kodi unik përdoruesi. Kjo zbatohet për të gjithë personat, pavarësisht nga rolet e tyre.

Ndalohet rreptësisht përdorimi nga më shumë se një person i kodit personal të përdoruesit dhe/ose e fjalëkalimit të tij. Thyerja e këtij rregulli do të trajtohet si një shkelje e rëndë.

Një kod unik përdoruesi nuk siguron vetëm mënyrën e autentifikimit për përdoruesit e ligjshëm, por gjithashtu garanton përcaktimin e përgjegjësisë së përdoruesve për aktivitetet e tyre në regjistrin elektronik të rekomandimeve.

Në të gjitha rastet, duhet të ndiqen procedura të dokumentuara për:

- regjistrimin e përdoruesve të rinj;
- ndryshimin e statusit për një përdorues ekzistues (për shembull ndërprerjen e llogarisë së përdoruesit kur ai largohet nga puna ose mungon për një kohë të gjatë ose ndryshimin e privilegjeve të aksesit të tij);
- mbylljen përfundimtare të një llogarie përdoruesi.

Natyra e këtyre procedurave dhe përgjegjësitë për administrimin e tyre mund të ndryshojnë në varësi të kategorisë së përdoruesit.

Llogaria e përdoruesit duhet të çaktivizohet nëse vërehen parregullsi në përdorimin e saj.

Administratorët e regjistrit elektronik të rekomandimeve janë përgjegjës për:

✓ **Regjistrimin e përdoruesve**

Drejtorja e IT-së është përgjegjëse për regjistrimin e përdoruesve që kanë akses në regjistrin elektronik të rekomandimeve. Për të çelur aksesin për një përdorues në modulën e regjistrit të rekomandimeve fillimisht duhet të dorëzohet një kërkesë për akses në sistem tek Drejtorja e IT-së, nëpërmjet formatit Kërkesa për Krijim / Modifikim / Fshirje të Llogarisë Përdorues sipas Aneksit 9 të Rregullores për funksionimin e sistemit SIMMPA, për aprovim. Aplikimi për akses duhet të dorëzohet vetëm nëse është aprovuar nga drejtori përkatës i Departamentit.

Kur një punonjës largohet nga KLSH, aksesin në regjistrin elektronik të rekomandimeve pezullohet brenda orarit zyrtar të ditës së fundit të punës së punonjësit. Është përgjegjësi e drejtorit të njësisë/departamentit të kërkojë pezullimin e të drejtave të aksesit nëpërmjet Kërkesës për Ndryshim/ Kërkesës për Shërbim drejtuar Drejtorisë IT-së të miratuar nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore.

✓ **Menaxhimi i aksesit të përdoruesit**

Procedurat formale të kontrollit të aksesit të përdoruesve duhet të dokumentohen, implementohen dhe të përditësohen për të siguruar akses të autorizuar të përdoruesve dhe për të parandaluar akses të pakufizuar. Ato duhet të mbulojnë të gjitha fazat e ciklit të jetës të aksesit të përdoruesve, nga regjistrimi fillestar i një përdoruesi deri tek çregjistrimi final i përdoruesit, kur nuk ka më nevojë për akses. Çdo përdoruesi duhet t'i caktohen të drejta aksesit dhe leje në sistem që:

- Janë në përputhje me detyrat që duhet të kryejë
- Ka një 'login' unik që nuk ndahet ose t'i bëhet i ditur përdoruesve të tjerë
- Ka në fjalëkalim unik që kërkohet në çdo login

Të drejtat e aksesit të përdoruesit duhet të rishikohen në interval të rregullt për të siguruar që të drejtat e duhura janë vendosur siç duhet. Llogaritë e administratorit të sistemit duhet t'i jepen përdoruesve që kryejnë detyrat e administrimit të sistemit.

✓ **Ndryshimi i rolit të përdoruesit në sistem**

Për çdo shtim përdoruesi apo ndryshim të roleve të përdoruesve që kanë akses në regjistrin elektronik, duhet të merret autorizimi përkatës nga eprori/Drejtori i Departamentit/Sekretari i Përgjithshëm.

Drejtorja e IT duhet të zbatojë proceset për:

- Ekzekutimin (pas miratimit) e ndryshimit të të drejtave të aksesit për punonjës që ndryshojnë detyrën dhe përgjegjësitë;
- Dhënia dhe revokimi i kredencialeve të autentifikimit duhet të kontrollohet nëpërmjet një procesi formal menaxhimi. Drejtorja e IT-së ka autoritetin për të lëshuar dhe rivendosur fjalëkalime.

4.3. Arkivimi i të dhënave

Të dhënat elektronike të regjistrit elektronik të rekomandimeve si pjesë integrale e sistemit SIMMPA arkivohen në mënyrë të tillë që të sigurojnë besueshmërinë, origjinalitetin, integritetin dhe përdorshmërinë e tyre në çdo kohë.

Arkivi elektronik mban gjurmët e auditimit të të gjithë atyre që kanë akses dhe kanë qasje në materiale të arkivuara përmes identifikimit të kontrolluar me fjalëkalim.

Rekordet e rekomandimeve dhe të gjithë dokumentet e tjera që janë pjesë e regjistrit të rekomandimeve pas përfundimit të të gjithë ciklit jetësor të tyre arkivohen dhe mund të aksesohen vetëm nga punonjës të autorizuar (Kryetar, Drejtor i Përgjithshëm, Specialist Statistikash, Drejtor Departamenti për departamentin përkatës).

E drejta për të parë të dhënat e arkivuara (rekomandimet me status ‘Mbyllur’ që do të thotë që ka përfunduar ciklin jetësor) është e kufizuar dhe mund të jepet për palët e treta me kërkesë vetëm pas miratimit me shkrim nga Kryetari apo personi i autorizuar prej tij.

Të gjithë dokumentet dhe rekordet e krijuar në sistem arkivohen në formën që janë krijuar dhe ruajtur, duke mos ndryshuar tërësinë e tyre;

- a. të gjithë dokumentet e krijuar në sistem ruhen nëpërmjet procedurave që sigurojnë garanci për pacënueshmërinë dhe tërësinë e tij gjatë gjithë kohës së ruajtjes, si dhe mos fshirjen pa autorizimin përkatës;
- b. të gjithë dokumentet e krijuar në sistem mundësojë përcaktimin në mënyrë të besueshme të çdo dokumenti elektronik, të origjinës së tij, krijuesit, kohës, mënyrës dhe formën e marrjes në sistemin e ruajtjes;

Kapitulli V. Raportimi i rezultateve të auditimit mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve.

5.1. Raportimi periodik për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve

Të dhënat e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve janë pjesë e buletinit 4-mujor që harton dhe publikon Kontrolli i Lartë i Shtetit. Për këtë qëllim Kryeaudituesi i ngarkuar me përditësimin e regjistrit elektronik departamental në bashkëpunim me Drejtorin me Departamentit dhe me konfirmimin e këtij të fundit përcjell tek specialisti i statistikës të dhënat e nevojshme të cilat merren nga regjistri elektronik i institucionit sipas formatit në Aneksin 4.6.

Informacioni i përcjellë përmban:

- Evidenca përmbledhëse për shkelje me dëm ekonomik të konstatuar gjatë auditimeve të ushtruara për të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën raportuese dhe statusi i pranimit.
- Evidenca për pasqyrimin e parregullsive të dispozitave ligjore në fuqi, për të ardhura të munguara ose shpenzime jo në përputhje me parimet e efektivitetit, eficiencës dhe ekonomicitetit, të cila kanë sjell efekt negativ financiar në të ardhurat e subjekteve dhe buxhetin e shtetit për periudhën raportuese dhe statusi i pranimit.
- Evidenca e Masave Disiplinore dhe Administrative të rekomanduara nga KLSH për periudhën raportuese
- Evidenca për ndryshime apo përmirësime ligjore dhe masat organizative të rekomanduara nga KLSH për periudhën raportuese dhe statusi i pranimit.
- Evidenca e masave organizative të rekomanduara nga KLSH për periudhën raportuese dhe statusi i pranimit.
- Evidenca e kallëzimeve penale për periudhën raportuese.

5.2. Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë lidhur me ecurinë e zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara.

Me synimin e rritjes së llogaridhënies dhe transparencës së organeve të qeverisjes qendrore dhe lokale, si dhe të gjithë institucioneve të cilat përdorin fonde publike, Kontrolli i Lartë i Shtetit vepron si “agjent” i Kuvendit për informimin e tij dhe të publikut për përdorimit me ekonomicitet, efektivitet dhe eficiencë të fondeve publike.

Për t'i bërë institucionet publike më të përgjegjshme, me Vendimin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë Nr. 134/2018 është miratuar dokumenti “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”, i cili rregullon mënyrën e raportimit të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj.

Detyrimi për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara lind edhe nga standardet e auditimit përkatësisht: ISSAI 10:7 “SAI-t paraqesin raportet e ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve tek Legjislativi, ose në një nga komisionet përkatëse, ose në bordin drejtues të subjektit të audituar, sipas rastit, për shqyrtim dhe marrjen e masave dhe kur SAI kanë kompetenca statutores për të dhënë sanksione”; ISSAI 20, pika 7, “SAI raporton publikisht mbi rezultatet e

auditimeve të tyre .. [përfshirë] masat e marra në lidhje me rekomandimet e tyre” dhe ISSAI 300, pika 42 “Ndjekja e rekomandimeve duhet të raportohet në mënyrë të përshtatshme për të ofruar feedback për Legjislativin” .

Në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ky manual Kontrolli i Lartë i Shtetit i cili vlerësohet se ka një rol të posaçëm në identifikimin e problematikave që lidhen me buxhetin e shtetit dhe performancën e institucioneve publike duhet të përcjellë pranë drejtorisë së Shërbimit të Monitorimit në Kuvend raporte përmbledhëse **çdo katër muaj** për rekomandimet e dhëna për institucionet e tjera

Për këtë qëllim, drejtuesit e departamenteve të auditimit në bashkëpunim me kryeaudituesit përcjellin pranë specialistit të statistikës informacionin e konsoliduar lidhur me rekomandimet dhe statusin e zbatimit të tyre.

Informacioni duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- emërtimin e departamentit (që ka hartuar rekomandimin);
- rekomandimin (e plotë siç gjendet në vendimin e Kryetarit të KLSH-së dhe në raportin përfundimtar);
- subjektin e audituar;
- afatin për zbatimin e rekomandimit;
- llojin e rekomandimit (p.sh., masë organizative, masë shpërblim demi etj.);
- shkallën e zbatimit (p.sh., pranuar, pranuar pjesërisht, i pa pranuar etj.) ;
- shënime (nëse ka).
- Anekset statistikore si më poshtë:
 1. Rekomandime për përmirësime/ ndryshime legjislativi;
 2. Masa organizative;
 3. Masa disiplinore;
 4. Masa administrative;
 5. Masa për shpërblim demi;
 6. Masa për eliminimin e efekteve negative

Për efekt të raportimit, departamentet e auditimit kanë detyrimin të plotësojnë në mënyrë progresive statusin e zbatimit të rekomandimeve.

5.3. Përditësimi me informacionin e nevojshëm të platformës elektronike të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Me qëllim marrjen e informacioneve të vazhdueshme dhe të përditësuara nga institucionet e pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për rekomandimet e lëna prej tyre dhe statusin e implementimit të këtyre rekomandimeve nga institucionet publike, Kuvendi i Shqipërisë ka krijuar dhe prej fundit të vitit 2019 funksionon platforma elektronike e informacionit të detajuar për rekomandimet.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i cili e ka në thelb të veprimtarisë së tij rekomandimin e masave korrigjuese për institucionet e qeverisjes qendrore e lokale që përdorin paranë publike duke bërë kështu që të jetë institucioni që ka numrin më të madh të rekomandimeve, krahasuar kjo me institucionet e tjera (vetëm në vitin 2018 KLSH kishte hartuar 4232 rekomandime për institucionet e audituara).

Për informimin e plotë dhe të përditësuar, sektori i statistikës plotëson në mënyrë të vazhdueshme platformën e Kuvendit të Shqipërisë me rekomandimet e lëna për

subjektet e audituara. Plotësimi i platformës bëhet në koordinim të plotë dhe të vazhdueshëm me departamentet e auditimit, të cilat me mbarimin e auditimit plotësojnë regjistrin e rekomandimeve me rekomandimet specifike.

Platforma e Kuvendit në fazën që sapo ka përfunduar auditimi plotësohet për çdo subjekt të audituar me informacionin e mëposhtëm:

- Vendimin e Kryetarit (dokumenti i skanuar në formantin PDF);
- Çdo rekomandim në formë narrative;
- Afatin për zbatimin e rekomandimit.

Platforma plotësohet dhe përditësohet sipas afateve ligjore të përcaktuara në Ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” me informacionet e mëposhtme:

- Planin e masave për zbatimin e rekomandimeve (dokumenti i skanuar i përcjellë nga subjekti i audituar);
- Statusin për çdo rekomandim (p.sh., pranuar, pa pranuar etj.);
- Informacionin e përcjellë nga subjekti i audituar në përmbushje të afatit gjashtë mujor, në të cilin raportohet implementimi konkret i planit të masave. (Në platformë vendoset i skanuar dokumenti i përcjellë nga subjekti)
- Statusi aktual (ecuria) i zbatimit të rekomandimit;

Statusi i zbatimit të rekomandimeve raportohet në platformën e Kuvendit sipas mënyrës së cituar më sipër edhe kur KLSH ndërmerr misione verifikuese për zbatimin e rekomandimeve ose ecuria e zbatimit të tyre është pikë e veçantë në misionin e ardhshëm auditues.

ANEKSE

Aneksi 1. Listë për monitorimin dhe zbatimin e rekomandimeve

Kjo pjesë përmban disa pyetje që audituesit duhet t'i konsiderojnë gjatë ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve të auditimit.

Pyetjet janë grupuar si më poshtë:

- Kur rekomandimet implementohen;
- Kur subjekti i audituar i merr në konsideratë rekomandimet dhe planifikon implementimin e atyre që pranon;
- Kur rekomandimet refuzohen, zbatohen në mënyre jo efektive ose zvarriten.

Planifikimi për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve

Hapi i parë është të planifikohet se si të nxitet subjekti i audituar të implementojë rekomandimin në mënyrë që të përmbushë objektivat e tij.

Pyetjet e mëposhtme ndihmojnë në përmirësimin e planit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve:

- A është bërë e qartë se çfarë impakti ka dhe cfare pritet të ndodhë në lidhje me implementimin e rekomandimeve?
- A i keni identifikuar përfitimet e pritshme nga zbatimi i rekomandimeve?
- A i keni identifikuar dhe konsideruar kostot oportune?
- Nëse baza ligjore është e paaplikueshme, a ka ligje apo rregullore të tjera të ngjashme që mund të merren në konsideratë?
- Kur pritet të fillojë implementimi?
- Kur pritet të përfundojë implementimi? A ka ngjarje që kushtëzojnë implementimin për një periudhë kohe?
- A ka një afat në të cilin rekomandimi duhet të jetë implementuar tërësisht?
- Kur mund të pritet realizimi i përfitimeve?
- A ka shfaqur subjekti kundërshtime gjatë auditimit, në takimin përmbysës, apo në observacionet e projekt raportit, apo pengesa për implementimin e rekomandimeve? A janë përfshirë këto observacione në raport? Çfarë mund të bëhet për gjatë ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve kundër këtyre pengesave?
- Çfarë do të bëhet për të monitoruar veprimet e rekomandimit?

Zbatimi i Planit

Pyetjet e mëposhtme duhen konsideruar përgjatë misionit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve:

- A po zbatohet korrektësisht rekomandimi nga subjekti?
- A jeni në dijeni të shkallës aktuale të pranimin dhe/ose të implementimit të rekomandimit? A është kjo e mjaftueshme?
- A e keni shqyrtuar planin e implementimit të përcjellë nga subjekti? A është ai i mjaftueshëm? Si do ta trajtonit ju pamjaftueshmërinë?
- A bini dakord ju dhe subjekti për përfitimin që sjell implementimi i rekomandimit? Nëse jo, a keni rënë dakord për një bazë mbi trajtimin e këndvështrimeve të ndryshme? Nëse subjekti refuzon zbatimin e rekomandimit, a bini dakord që ky veprim është i përshtatshëm?
- A japin dokumentet e vëna në dispozicion dhe mënyra e raportimit siguri të arsyeshme për implementimin e rekomandimit?
- A i keni ndërmarrë të gjitha veprimet e përcaktuara në planin tuaj të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve gjatë kryerjes së auditimit të posaçëm?

Ndërmarrja e hapave shtesë kur nevojiten

Përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme duhet të merren në konsideratë kur një rekomandim nuk pranohet/ nuk zbatohet, zbatohet joefektivisht ose zvarritet implementimi i tij:

- *Sipas mendimit tuaj, a është rekomandimi ende i vlefshëm? Nëse po, a janë arsyet e subjektit për mos implementimin e rekomandimit të qenësishme?*
- A mund të kishin në thelb një qasje alternative objektivat e rekomandimit?
- A mund të bëhet diçka tjetër në mënyrë që rekomandimi të implementohet? Nëse po çfarë mund të bëhet?
- A është një rekomandim kyç apo kryesor? A është mjaftueshëm i rëndësishëm për t'u referuar një autoriteti më të lartë për veprim, si p.sh. të kërkohet ndërhyrje e jashtme apo të përfshihet dhe menaxhimi i lartë i institucionit auditues? Çfarë veprimesh shtesë mendoni se do të ishin të përshtatshme?
- A mund të ketë diçka në formulimin e rekomandimit që për rrjedhojë e ka bërë të vështirë pranimin dhe implementimin e tij?

Aneksi 2. Raporti i konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.xxxx-30.06.xxxx, përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë në muajin Mars të vitit aktual dhe Shkresa përcjellëse



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT I KONSOLIDUAR I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NGA 01.01.XXXX-30.06.XXXX**

Tiranë, më

faqe 1 nga x

Nr	Përmbajtja	Faqe
1.	Përmbledhje ekzekutive	
1.1	Hyrje	
1.2	Objektivat	
1.3	Qëllimi	
1.4	Metodologjia	
1.5	Konkluzione	
2.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	
3.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.XXXX-30.06.XXXX	
3.1	Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore	
3.2	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	
3.3	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	
3.4	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	
3.5	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të huaja	
3.6	Departamenti i Auditimit të Performancës	
3.7	Departamenti i Auditimit të TI-së	
3.8	Departamenti i Auditimit të Inovacionit dhe Sistemeve	
4.	Anekse	
4.1	Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislacioni	
4.2	Masa organizative	
4.3	Masa disiplinore	
4.4	Masa administrative	
4.5	Masa shpërblim dëmi	
4.6	Masa për eliminimin e efekteve negative	

faqe 2 nga x

1. Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhja ekzekutive është një formë e shkurtuar e Raportit dhe përmban informacionet më të rëndësishme mbi procesin e monitorimit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.XXXX-30.06.XXXX.

Përmbledhja Ekzekutive përmban gjithashtu mënyrën e zbatimit të procesit të verifikimit sistematik të zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara të cilat i lejojnë jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë, etj., të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara, për iniciativat e ndërmarra për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.

Struktura e Përmbledhjes Ekzekutive është si më poshtë vijon:

- 1.1 **Hyrje** - në këtë pjesë do të përshkruhet shkurtimisht baza për kryerjen e Raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve dhe ecuria e procesit, mbështetur në bazën ligjore të KLSH.
- 1.2 **Objektivat** – lidhet me përcaktimin e objektivave mbi të cilat kryhet ky Raport i Konsoliduar për vlerësimin dhe sigurimin e raportimit të detajuar të zbatimit të rekomandimeve
- 1.3 **Qëllimi** – lidhet me detyrimin për raportimin në Kuvend të statusit të zbatimit të rekomandimeve mbi bazën e monitorimit të vazhdueshëm që KLSH i bën statusit të zbatimit të tyre
- 1.4 **Metodologjia** – lidhet me metodologjinë e përdorur për të arritur evidentimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve dhe ecurinë e zbatimit të tyre
- 1.5 **Konkluzione** – Kjo pjesë synon të japë konkluzionin e përgjithshëm të rezultuar nga procesi i verifikimit të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve
2. **Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve** - është dhënia e opinionit të rezultuar nga procesi i verifikimit të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve
3. **Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.XXXX-30.06.XXXX** – një përshkrim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për çdo Departament, ilustruar me grafikë dhe përmbledhje tabelore të evidencave të zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara
 - 3.1 Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
 - 3.2 Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
 - 3.3 Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
 - 3.4 Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
 - 3.5 Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të huaja
 - 3.6 Departamenti i Auditimit të Performancës
 - 3.7 Departamenti i Auditimit të TI-së
 - 3.8 Departamenti i Auditimit të Inovacionit dhe Sistemeve
4. **Anekse** - Seksionit “Anekse” do t’i kushtohet rëndësi e veçantë duke synuar vendosjen e tabelave dhe pasqyrave përmbledhëse në nivel institucional, të cilat argumentojnë zbatimin e rekomandimeve të ndara sipas llojit
 - 4.1 Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislativi
 - 4.2 Masa organizative

- 4.3 Masa disiplinore
- 4.4 Masa administrative
- 4.5 Masa shpërblim dëmi
- 4.6 Masa për eliminimin e efekteve negative

Anekset do të jenë sipas formateve të mëposhtme

Nr	Subjekti i Audituar	Rekomandime Gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit ne %	Statusi i rekomandimeve te pranuar			
						Pa Zbatuar	Zbatuar	Zbatuar	Ne
							Pjeserisht		Proces zbatimi
TOTALI									

Shkresa përcjellëse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/____

Lënda: Dërgim i Raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve

Drejtuar: **Z. XXXXXX**
KRYETAR
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Në zbatim të kërkesave të nenit 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 31 “Raportimi në Kuvend”, Ju përcjellim Raportin e Konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.XXXX-30.06.XXXX.

Duke Ju falënderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin,

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

Aneksi 3. Raporti i konsoliduar i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.xxxx-31.12.xxxx, përcjellë në Kuvendin e Shqipërisë ne muajin Shtator të vitit aktual dhe Shkresa përcjellëse



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**RAPORT I KONSOLIDUAR I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË LËNA NË
AUDITIMET E MËPARSHME TË EVADUARA NGA 01.01.XXXX-31.12.XXXX**

Tiranë, më

faqe 1 nga x

Nr	Përmbajtja	Faqe
1.	Përmbledhje ekzekutive	
1.1	Hyrje	
1.2	Objektivat	
1.3	Qëllimi	
1.4	Metodologjia	
1.5	Konkluzione	
2.	Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve	
3.	Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.XXXX-30.06.XXXX	
3.1	Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore	
3.2	Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit	
3.3	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit	
3.4	Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore	
3.5	Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të huaja	
3.6	Departamenti i Auditimit të Performancës	
3.7	Departamenti i Auditimit të TI-së	
3.8	Departamenti i Auditimit të Inovacionit dhe Sistemeve	
4.	Aneks	
4.1	Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislativi	
4.2	Masa organizative	
4.3	Masa disiplinore	
4.4	Masa administrative	
4.5	Masa shpërblim dëmi	
4.6	Masa për eliminimin e efekteve negative	

faqe 2 nga x

1. Përmbledhje ekzekutive

Përmbledhja ekzekutive është një formë e shkurtuar e Raportit dhe përmban informacionet më të rëndësishme mbi procesin e monitorimit dhe zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.XXXX-31.12.XXXX.

Përmbledhja Ekzekutive përmban gjithashtu mënyrën e zbatimit të procesit të verifikimit sistematik të zbatimit të rekomandimeve nga subjektet e audituara, bazuar në metodologji dhe procedura të standardizuara, të qarta dhe të mirë detajuara të cilat i lejojnë jo vetëm Kontrollit të Lartë të Shtetit por dhe palëve të treta Kuvendit, Qeverisë etj, të sigurojnë në vijimësi, një informacion të plotë, lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana e subjekteve të audituara, për iniciativat e ndërmarra për hartimin e dokumenteve strategjike në nivel institucional dhe kombëtar apo për iniciativa për ndryshime ligjore, administrative dhe organizative.

Struktura e Përmbledhjes Ekzekutive është si më poshtë vijon:

- 1.1 **Hyrje** - në këtë pjesë do të përshkruhet shkurtimisht baza për kryerjen e Raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve dhe ecuria e procesit, mbështetur në bazën ligjore të KLSH.
- 1.2 **Objektivat** – lidhet me përcaktimin e objektivave mbi të cilat kryhet ky Raport i Konsoliduar për vlerësimin dhe sigurimin e raportimit të detajuar të zbatimit të rekomandimeve
- 1.3 **Qëllimi** – lidhet me detyrimin për raportimin në Kuvend të statusit të zbatimit të rekomandimeve mbi bazën e monitorimit të vazhdueshëm që KLSH i bën statusit të zbatimit të tyre
- 1.4 **Metodologjia** – lidhet me metodologjinë e përdorur për të arritur evidentimin e statusit të zbatimit të rekomandimeve dhe ecurinë e zbatimit të tyre
- 1.5 **Konkluzione** – Kjo pjesë synon të japë konkluzionin e përgjithshëm të rezultuar nga procesi i verifikimit të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve
2. **Opinion i përgjithshëm mbi zbatimin e rekomandimeve** - është dhënia e opinionit të rezultuar nga procesi i verifikimit të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve
3. **Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduara nga 01.01.XXXX-31.12.XXXX** – një përshkrim mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve për çdo Departament, ilustruar me grafikë dhe përmbledhje tabelore të evidencave të zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara
 - 3.1 Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore
 - 3.2 Departamenti i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit
 - 3.3 Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Shtetit
 - 3.4 Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore
 - 3.5 Departamenti i Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të huaja
 - 3.6 Departamenti i Auditimit të Performancës
 - 3.7 Departamenti i Auditimit të TI-së
 - 3.8 Departamenti i Auditimit të Inovacionit dhe Sistemeve
4. **Anekse** - Seksionit “Anekse” do t’i kushtohet rëndësi e veçantë duke synuar vendosjen e tabelave dhe pasqyrave përmbledhëse në nivel institucional, të cilat argumentojnë zbatimin e rekomandimeve të ndara sipas llojit
 - 4.1 Rekomandimet për përmirësime/ndryshime legjislativi
 - 4.2 Masa organizative

- 4.3 Masa disiplinore
- 4.4 Masa administrative
- 4.5 Masa shpërblim dëmi
- 4.6 Masa për eliminimin e efekteve negative

Anekset do të jenë sipas formateve të mëposhtme

Nr	Subjekti i Audituar	Rekomandime Gjithsej	Pa pranuar	Pranuar	Shkalla e pranimit ne %	Statusi i rekomandimeve te pranuar				
						Pa Zbatuar	Zbatuar Pjeserisht	Zbatuar	Ne Proces zbatimi	
TOTALI										

Shkresa përcjellëse



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. _____ Prot

Tiranë, më ____/____/____

Lënda: Dërgim i Raportit të konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve

Drejtuar: **Z. XXXXXX**
KRYETAR
KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Në zbatim të kërkesave të nenit 164 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 ‘‘Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit’’ neni 31 ‘‘Raportimi në Kuvend’’, Ju përcjellim Raportin e Konsoliduar të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme të evaduar nga 01.01.XXXX-31.12.XXXX.

Duke Ju falënderuar për mbështetjen dhe bashkëpunimin,

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R

Aneksi 4. Regjistri Elektronik

4.1. Menuja e Regjistrit elektronik të rekomandimeve.

The screenshot shows the RevZone Business Management System interface. The top navigation bar includes 'Options', 'Main', 'View', 'Tools', 'Dashboard', and 'About'. Below this is a search and navigation area with 'Search all', 'Refresh', 'New', 'Properties', and 'Send to Process' buttons. A search type dropdown is set to 'All Words', and there are checkboxes for 'Search options' and 'Include subfolders'. The main content area displays a list of processes under the heading 'Proçese'. The list is filtered to show 2 results. The first result is 'Proçese KLSH' with a progress of 0% and a checked out date of 22/Dec/2017 16:08. The second result is 'Dërgim Raportesh' with a progress of 0% and a checked out date of 25/Dec/2017 12:14. The left sidebar contains a navigation menu with 'Kreu', 'Dokumentat', 'Proçese', 'Çështjet', and 'Raporte'. The 'Proçese' menu item is highlighted with a red box and a circled '1'. The 'Proçese KLSH' menu item is also highlighted with a red box and a circled '2'. The first row of the table is highlighted with a red box and a circled '3'.


Nr Procesi	Përshkrim	Progress	Checked Out Date	Parent Process	Created Date
KLSH-2017-000016	00000088 - DSHTD (Rregjistri i Rekomadimeve)	0 %	22/Dec/2017 16:08		22/Dec/2017 16:08
KLSH-2017-000017	00000090 - DSHTD (Rregjistri i Rekomadimeve)	0 %	25/Dec/2017 12:14		25/Dec/2017 12:14

4.2. Lista e rekomandimeve që gjenden në regjistër.

The screenshot shows the RevZone Business Management System interface with a detailed list of recommendations. The top navigation bar and search area are the same as in the previous screenshot. The main content area displays a list of processes under the heading 'Proçese'. The list is filtered to show 7 results. The first result is 'Proçese KLSH' with a progress of 0% and a checked out date of 22/Dec/2017 16:08. The second result is 'Dërgim Raportesh' with a progress of 0% and a checked out date of 25/Dec/2017 12:15. The third result is 'Nënkëqja dhe zbatimi i Rekomandimeve' with a progress of 0% and a checked out date of 01.0er.2020 14:10. The fourth result is 'Auditim Test per Regjistrin' with a progress of 100% and a checked out date of 01.0er.2020 14:13. The fifth result is 'Auditim Test per Regjistrin' with a progress of 0% and a checked out date of 01.0er.2020 14:13. The sixth result is 'Fund' with a progress of 0% and a checked out date of 01.0er.2020 14:13. The seventh result is 'Drejtoria Juridike ndjek rekomandimin' with a progress of 0% and a checked out date of 01.0er.2020 14:18. The left sidebar contains a navigation menu with 'Home', 'Documents and Records', 'Processes', 'Project', 'Reports', and 'Relationships'. The 'Processes' menu item is highlighted with a red box and a circled '1'.

Nr Procesi	Përshkrim	Progress	Checked Out Date	Parent Process	Created Date	Last Modified Date	Checked Out PC	Checked Out By	Faza Aktuale	Field Group	Created By	Last Modified By
KLSH-2017-000016	00000088 - DSHTD (Rregjistri i Rekomadimeve)	0%	22.0er.2017 16:08		22.0er.2017 16:08	22.0er.2017 16:08			Drejtoria Juridike ndjek rekomandimin	Default	Admin System	Admin System
001 KLSH-000007	G0229 - ; G0228 -	0%	01.0er.2020 14:10	KLSH-000007	01.0er.2020 14:10	01.0er.2020 14:11	ASUDUALOSAKITTA	Aldo Kita	Aplikanti krijon cështjen	Default	Aldo Kita	Aldo Kita
KLSH-000007	G0229 - ; G0228 -	0%	01.0er.2020 14:10		01.0er.2020 14:10	01.0er.2020 14:10	ASUDUALOSAKITTA	Aldo Kita	Aplikanti krijon cështjen	Default	Aldo Kita	Aldo Kita
001 KLSH-000008	Auditim Test per Regjistrin	100%	01.0er.2020 14:13	KLSH-000008	01.0er.2020 14:13	01.0er.2020 14:13	ASUDUALOSAKITTA	Aldo Kita	Aplikanti krijon cështjen	Default	Aldo Kita	Aldo Kita
KLSH-000008	Auditim Test per Regjistrin	0%	01.0er.2020 14:13		01.0er.2020 14:13	01.0er.2020 14:13			Fund	Default	Aldo Kita	Aldo Kita
KLSH-000009	G0231 -	0%	01.0er.2020 14:18		01.0er.2020 14:18	01.0er.2020 14:18			Drejtoria Juridike ndjek rekomandimin	Default	Aldo Kita	Aldo Kita

4.3. Të dhënat që ruhen në regjistrë për secilin prej rekomandimeve.



4.4. Rrjedha logjike e ciklit jetësor të rekomandimit.




Tabela e shkurtimeve

INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit të Shtetit
IFPP	Deklaratat Profesionale të Kornizës INTOSAI
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
SAI	Institucionet Supreme të Auditimit
IT	Teknologji Informacioni
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
IDI	Iniciativa për zhvillim e INTOSAI
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
SIMMPA	Sistemit të Informacionit për Mbështetjen dhe Menaxhimin e Proceseve të Auditimit

Ky material u përgatit nga grupi i punës ngritur me Urdhrin nr. 45 datë 31.03.2020 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e manualit të ndjekjes së zbatimit të rekomandimeve si dhe të regjistrit institucional të zbatimit të rekomandimeve”

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT